

# NGA VARSHAVA NË TIRANË: TEJKALIMI I SË KALUARËS SË BASHKU

Praktika të mira dhe mësimet të nxjerra nga Grupi  
i Vishegradit dhe Ballkani Perëndimor



• supported by

• Visegrad Fund





TË DREJTAT E AUTORIT © 2019  
Nga Varshava në Tiranë: Tejkalimi i së kaluarës së bashku

EUROPEUM Institute for European Policy, Republika Çeke  
Research Center of the Slovak Foreign Policy Association, Sllovaki  
Institute for Foreign Affairs and Trade, Hungari  
European Movement in Serbia, Serbi  
WiseEuropa Institute, Poloni  
Academy of European Integration and Negotiation, Shqipëri



**SFPA**  
Slovak Foreign Policy Association



**European  
Movement  
Serbia**



**WiseEuropa**



**AKADEMIA E INTEGRIMIT  
EUROPIAN DHE NEGOCIATAVE**



Co-funded by the  
Europe for Citizens Programme  
of the European Union

Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Botimi nuk mund të riprodhohet plotësisht ose pjesërisht, në çfarëdo forme, pa lejen me shkrim të botuesve, përveçse nga një recensues, i cili mund të citojë fragmente në një recensë.

Mbështetja e Komisionit Europian për prodhimin e këtij botimi nuk përbën një miratim të përmbytjes, e cila pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve, dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacioneve të përmbytura në të.



## TABELA E LËNDËS

Parathënie <i>Jana Juzová</i>	4
Uljet dhe ngritjet e paktimit polako-gjerman dhe mësimet për Ballkanin Perëndimor <i>Adam Balcer, Klaus Ziemer</i>	5
Divorci i Kadifenjtë: Shpërbërja e Çekoslovakisë si një frymëzim për Ballkanin Perëndimor <i>Tatiana Chovancová, Jana Juzová</i>	13
Pajtimi sllovak-hungarez dhe mësimet për Ballkanin Perëndimor <i>Nikolett Garai, Tomáš Strážay</i>	20
Tejkalimi i trashëgimisë të së kaluarës së bashku: Serbia dhe Hungaria <i>Igor Novakovic, Anna Orosz</i>	29
Marrëdhëniet Shqipëri - Serbi: Ura mbi ujërat e trazuar <i>Gentiola Madhi, Jelica Minić,</i>	38
Konkluzione: Çfarë mund të mësojë Ballkani Perëndimor nga paktimi i Vishegradit? <i>Jana Juzová</i>	47

## Parathënie

Pajtimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë ndër prioritetet kryesore të Procesit të Stabilizim-Asociimit të Ballkanit Perëndimor dhe paraqesin një kusht të domosdoshëm për përparimin e vendeve të rajonit drejt BE-së. Është bërë e qartë se pa ndërmarrjen e një procesi që mbështet përballjen me trashëgiminë e së kaluarës, të mbushur me konflikte, dhunë, përçarje dhe paragjykime të ndërsjellta, rajoni nuk do të jetë i aftë të përparojë nga gjendja pezull në të cilën ka ngecur prej njëzet vjetësh, që prej konfliktit të fundit të dhunshëm.

Megjithë përpjekjet dhe burimet e konsiderueshme të investuara nga BE-ja për pajtimin në Ballkanin Perëndimor, përmes platformave dhe instrumenteve të ndryshme dhe aktiviteteve të shoqërisë civile në të gjithë rajonin, relativisht vetëm pak përparim është bërë në këtë proces tepër kompleks dhe të ndjeshëm. Ndjenjat dhe pakënaqësitë karshi "tjetrit" janë ende të larta në shoqëri, duke siguruar mundësi të lehta për manipulime nga liderët politikë nacionalistë. Ende ekziston nevoja për më shumë nisma me pronësi rajonale dhe zbatim real të hapave që avancojnë përpara procesin e pajtimit. Një hap në drejtimin e duhur ka qenë krijimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO), e cila nxit procesin e pajtimit dhe stabilitetit me një fokus specifik tek rinia si një aktor kryesor në formësimin e së ardhmes së rajonit, dhe Fondi për Ballkanin Perëndimor (WBF), që synon të mbështesë nismat lokale rajonale (grass-root) që vijnë nga shoqëria civile dhe sektori joqeveritar. Sidoqoftë, të dy institucionet janë ende në procesin e themelimit të tyre në skenën rajonale dhe mbeten shumë të ndjeshëm ndaj ndikimit politik, duke u shndërruar ndonjëherë në pengje të mosmarrëveshjeve dypalëshe.

Në përmirësimin e procesit të pajtimit, shembujt dhe praktikat më të mira nga shtetet dhe rajonet e tjera mund të shërbejnë si frymëzim. Ky ishte rasti i RYCO-s, i cili u krijua sipas shembullit të Këshillit Rinor Franko-Gjerman, dhe i Fondit për Ballkanin Perëndimor, i themeluar sipas modelit të Fondit Ndërkombëtar të Vishegradit, një institucion i suksesshëm në kuadrin e bashkëpunimit midis vendeve të Vishegradit (Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia). Duke u mbështetur në këto shembuj të mëparshëm pozitivë, ky projekt u përqëndrua në proceset e pajtimit dhe praktikat e aplikuara në vendet e Vishegradit, rajon me ngjashmëri me Ballkanin Perëndimor, me përvojën e tij historike, përzierjen e ndërlikuar të pakicave kombëtare dhe tensionet ndëretnike që burojnë nga e kaluara e vështirë dhe shpesh e dhunshme.

Me qëllim identifikimin e praktikave të mira, por edhe të shembujve më pak pozitivë dhe mësimëve të nxjerra të zbatueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, janë hartuar pesë raste studimore të që analizojnë marrëdhëniet e ndryshme dypalëshe: Poloni-Gjermani, Çeki-Slovakia, Sllovakia-Hungari, Hungari-Serbi, Serbi-Shqipëri. Qëllimi i këtyre rasteve studimore është të ofrojë një panoramë të rasteve të ofruara, të identifikojë praktikat e mira dhe gjithashtu dështimet në pajtimin dhe normalizimin midis shteteve dhe shoqërive në proceset respektive të përballjes me të kaluarën, dhe në bazë të këtyre analizave të nxjerrë mësimë dhe rekomandime për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Përpos rekomandimeve praktike dhe frymëzimit për nisma konkrete, hulumtimi i kryer në këtë projekt zbulon elementë të përbashkët dhe hedh dritë për ndërtimin e një procesi të suksesshëm pajtimi dhe normalizimi të marrëdhënieve reciproke. Rastet studimore tregojnë se marrëdhëniet e ndërlikuara ndër-etnike dhe çështjet e pakicave nuk janë problem i kufizuar vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe vende të tjera janë marrë me çështje të ngjashme. Përvoja e suksesshme e bashkëpunimit rajonal mes vendeve të Vishegradit, si dhe integrimi evropian ndihmojnë më tej për të sqaruar se si dhe me çfarë kufizimesh këto dy procese, të dy mes objektivave kryesore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, mund të mbështesin pajtimin midis vendeve dhe komuniteteve.

Jana Juzová, Hulumtuese, EUROPEUM Institute for European Policy

# Uljet dhe ngritjet e pajtimit polako-gjerman dhe mësimet për Ballkanin Perëndimor

*Adam Balcer, Klaus Ziemer*

## Hyrje

Në 2017, Ministria e Punëve të Jashtme polake ndërmori seminarin “Pajtimi dhe Përkujtimi”, i cili synon të shkëmbejë përvojën e pajtimit polako-gjerman, si një frymëzim për përmirësimin e marrëdhënieve midis kombeve të Ballkanit Perëndimor dhe tejkalimin e barrierave historike. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Fondacionin Krzyżowa dhe ambasadën gjermane. Padyshim, pajtimi polako-gjerman mund të shërbejë në një farë mase si një burim frymëzimi për proceset e ngjashme që po ndodhin në Ballkanin Perëndimor. Rëndësia e pajtimit polako-gjerman buron nga shfaqja apo karakteri i tij paradigmatic. Lily Gardner Feldman, e cila ka studiuar politikën e pajtimit të Gjermanisë së pasluftës dhe Polonisë,<sup>1</sup> zbuloi se sukcesi i saj bazohet në përmbushjen e pesë kriterëve të cilat janë thelbësorë për çdo proces pajtimi:

1. “Vizionet”. Politikanët duhet të dinë se si duhet të duken marrëdhëniet midis shteteve dhe shoqërive të tyre në të ardhmen dhe të hartojnë një strategji drejt realizimit të këtij qëllimi.
2. “Lidershipi”. Një politikan, i cili është i bindur për “vizionin” e tij, duhet të përpiqet t’a zbatojë atë edhe kundër opozitës politike.
3. “Simbolet”. Ato i japin procesit të pajtimit një dimension të nevojshëm emocional.
4. “Përballja me historinë”. Kjo shqetëson nga njëra anë diskutimin e sinqertë të historianëve të të dy palëve për çështje të vështira të historisë së përbashkët. Nga ana tjetër, krimet e kryera duhet të ndëshkohen.
5. “Vazhdimësia e bashkëpunimit institucional”. E rëndësishme për vazhdimësinë e bashkëpunimit dypalësh në nivel lokal (grass-root) është mbështetja financiare publike e qëndrueshme, p. sh. për partneritete midis qyteteve.

Nga ana tjetër, ideja e pajtimit polako-gjerman si pikë referimi për procese të tilla në Ballkanin Perëndimor përballet me kufizime të caktuara. Dallimi kryesor midis pajtimit polako-gjerman dhe çështjeve të Ballkanit Perëndimor buron nga veçantia e trashëgimisë së të kaluarës në rastin e parë. Përballimi me të kaluarën e përçarë të Ballkanit Perëndimor kërkon diskutim jo vetëm për konfliktet më të fundit (1991-1999) midis serbëve dhe fqinjëve të tyre (shqiptarët, boshnjakët, kroatët), por edhe për trashëgiminë e përplasjeve midis tyre që kanë ndodhur në shekujt e 19<sup>të</sup>-20<sup>të</sup>, përfshirë edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndërkohë, trashëgimia e Luftës së Dytë Botërore zë një vend

---

<sup>1</sup> Feldman, L.G., *Germany's Foreign Policy of Reconciliation. From Enmity to Amity*, Lanham et al. 2012.

qendror në pajtimin polako-gjerman. Sidoqoftë, numri i të vdekurve (të paktën 2 milion polakë etnikë), asimetria dramatike midis numrit të viktimave përkatësisht polakë dhe gjermanë, dhe thjeshtësia (Gjermania naziste si autori kryesor) pasqyrojnë ndryshimet kryesore midis çështjes polako-gjermane dhe asaj të Ballkanit Perëndimor në tërësi.

Gjenocidi i kryer nga fashistët kroatë (Ustasha)<sup>2</sup> kundër serbëve në Bosnje dhe Kroaci paraqet relativisht rastin më të ngjashëm me shfarosjen masive të polakëve nga gjermanët nazistë. Gjithsesi, edhe në atë rast mund të vërehen dallime të konsiderueshme. Për shembull, asimetria midis numrit të serbëve të vrarë nga kroatët dhe boshnjakët karshi këtyre të fundit të vrarë nga serbët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më vonë ishte vendosmërisht më e vogël se pabarazia e numrit të vdekjeve midis polakëve dhe gjermanëve. Për më tepër, në atë periudhë, përveç viktimave të gjenocidëve<sup>3</sup> dhe krimeve kundër njerëzimit në Bosnjë dhe Kroaci, shumë njerëz vdiqën për shkak të konflikteve me karakter të ndryshëm sesa thjesht kombëtar (luftë politike civile, luftë kundër okupatorëve). Pabarazia midis çështjes polako-gjermane dhe konflikteve të zhvilluara në vitet '90 në ish-Jugosllavi në lidhje me numrin e vdekjeve dhe asimetrinë përsa i përket prejardhjes etnike të viktimave është edhe më e dukshme.<sup>4</sup> Së dyti, nxjerrja e mësimave nga pajtimi polako-gjerman, siç do të ilustruhet në tekstin tonë, kërkon njohje jo vetëm të sukseseve por edhe të dështimeve të tij. Në përgjithësi, çështja polako-gjermane konfirmon brishtësinë e proceseve të pajtimit dhe se instrumentalizimi i së kaluarës nga politikanët paraqet sfidën më të rëndësishme të pajtimit.

## **Rasti studimor i pajtimit polako-gjerman**

Polakët dhe gjermanët kishin disa shekuj histori të përbashkët të karakterizuar më shumë nga bashkëjetesa sesa konfrontimi. Gjithsesi, Lufta e Dytë Botërore helmoi marrëdhëniet polako-gjermane në një shkallë që vështirë se mund të ishte më keq. Agresioni gjerman kundër Polonisë në 1939 u pasua nga një politikë shfarosëse sistematike, e cila duhet të njihet si gjenocid. Gjermanët i justifikuan krimet e tyre në bazë të teorisë raciste naziste, e cila i konsideronte polakët etnikë si racë inferiorë *Untermenschen*. Masterplani nazist përfshinte dëbimin e shumicës së polakëve etnikë, skllavërimin e pjesës tjetër të tyre dhe shfarosjen e elitave. Në të vërtetë, përmes luftës polakët etnikë pësuan persekutime brutale të përditshme nga autoritetet okupuese gjermane, shkatërrim të trashëgimisë kulturore, ekzekutime masive (sidomos gjatë Kryengritjes së Varshavës në 1944), burgosje në kampe përqendrimi, punë të detyruar dhe dëbime dhe gjermanizim. Deri në vitin 1942,

---

<sup>2</sup> Tomasevich J., *War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945 Occupation and Collaboration*, Stanford 2001, fq. 380-415.

<sup>3</sup> Disa masakra të shoqëruara nga spastrime etnike të kryera nga forcat nacionaliste serbe (çetnikët) duhet të njohen si gjenocid. Forcat komuniste janë gjithashtu autorë të krimeve masive kundër njerëzimit, gjatë luftës dhe më pas. Gjithsesi, të gjitha këto krime nuk përputheshin me gjenocidin e kryer Ustasha. Tomasevich J., *War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945: The Chetniks*. Stanford 1975.

<sup>4</sup> Në vitet 1990, numri i viktimave kroate, boshnjake dhe shqiptare në konfliktet me serbët ishte më i lartë sesa numri i viktimave serbe. Një hendek veçanërisht i madh ekziston midis viktimave serbe në njërën anë dhe boshnjakëve dhe shqiptarëve nga ana tjetër.



Polonia u bë arena kryesore e zbatimit të planit nazist për të vrrarë çdo hebre në Europën e pushtuar gjermane (getot, kampet e vdekjes).

Si pasojë e politikave gjenocidale gjermane, rreth 5,5 milion (nga 35 milion në 1939) qytetarë polakë u vranë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më shumë se 90% e tre milion hebrenjve polakë u shuan nën komandën gjermane.<sup>5</sup> Në 1945, tre fuqitë e mëdha në Jaltë dhe Potsdam vendosën t'i japin Bashkimit Sovjetik pothuajse të gjitha territoret lindore të Polonisë, të cilat tashmë në 1939 ishin okupuar nga Ushtria e Kuqe në bazë të Paktit Ribbentrop-Molotov. Polonia mori në këmbim territoret gjermane në lindje të lumenjve Oder dhe Neisse (përveç pjesës veriore të Prusisë Lindore që iu dha Bashkimit Sovjetik). Shumica absolute e gjermanëve që jetonin në këto rajone u arratisën ose u dëbuan nga vendlindjet e tyre, si pasojë e aktiviteteve të Ushtrisë së Kuqe dhe autoriteteve komuniste polake, drejtë Gjermanisë, kryesisht të shkatërruar në kufijtë e saj të rinj. Disa qindra mijëra prej tyre u zhdukën për shkak të urisë, sëmundjeve, rraskapitjes dhe masakrave.<sup>6</sup>

Gjatë dekadës së parë pas 1945 ishte shumë e kuptueshme që polakët kishin një antipati të thellë ndaj gjermanëve. Nga ana tjetër, shumë gjermanë e konsideruan veten viktimat të luftës (të dëbuar, viktimat të bombardimeve aleate etj.), pa marrë parasysh se cila ishte arsyeja e fatit. Kontaktet midis polakëve dhe gjermanëve u bënë edhe më të vështira në fillim të Luftës së Ftohtë dhe ndarjes së Gjermanisë. Në nivel shtetëror, nuk ekzistonin marrëdhënie diplomatike midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Polonisë komuniste deri më 1972. Një përparim në ligjërimin publik rreth Polonisë dhe vendeve të tjera në lindje të Gjermanisë u shënuar në tetor 1965 në një memorandum të Kishës Protestante gjermane mbi marrëdhëniet midis gjermanëve dhe fqinjëve të tyre lindorë.<sup>7</sup> Nga njëra anë, u ekspozuan vuajtjet e të dëbuarve gjermanë dhe kontributi i tyre në ndërtimin e Gjermanisë së pasluftës. Nga ana tjetër, për herë të parë çështja e fajit gjerman dhe cilat pasoja duhej të mbartte Gjermania për këtë u bë temë e debatit publik. Ky memorandum nisi një diskutim të ashpër të paparë në publik dhe përçau shoqërinë gjermane. Në periudhën afatgjate, megjithatë, ky memorandum kontribuoi me një perspektivë të re të përgjegjësisë gjermane për Luftën e Dytë Botërore dhe krimet që kishin kryer gjermanët. Ai i hapi gjithashtu rrugën "nga lart-poshtë" të Willy Brandt-it për Ostpolitik-ën e tij dhe pranimit të kufirit polako-gjerman të pasluftës nga shoqëria gjermane.

Nga ana polake, pak javë pas publikimit të memorandumit nga Kisha Protestante, peshkopët katolikë polakë të pranishëm në Romë gjatë këshillit të Dytë të Vatikanit, i drejtuan në nëntor 1965 një letër peshkopëve gjermanë.<sup>8</sup> Si autoriteti moral i shoqërisë polake, veçanërisht nën sundimin komunist, peshkopët katolikë përshkruan në këtë letër

---

<sup>5</sup> Materski W., Szarota T., Polska 1939–1945, straty osobowe i ofiary represji pod dwiema okupacjami, Instytut Pamięci Narodowej, Warsaw 2009.

<sup>6</sup> Douglas R. M., Orderly and Humane. The Expulsion of the Germans after the Second World War, Yale University Press, 2012.

<sup>7</sup> "Evangelische Kirche in Deutschland, Die Lage der Vertriebenen und das Verhältnis des deutschen Volkes zu seinen östlichen Nachbarn", Hannover 1965, [https://www.ekd.de/ekd\\_de/ds\\_doc/ostdenkschrift\\_1965.pdf](https://www.ekd.de/ekd_de/ds_doc/ostdenkschrift_1965.pdf) [31 Tetor 2019].

<sup>8</sup> "Konferencja Episkopatu Polski, Orędzie biskupów polskich do ich niemieckich braci w chrystusowym urzędzie pasterskim", [https://opoka.org.pl/biblioteka/W/WE/kep/orędzie-niem\\_18111965.html](https://opoka.org.pl/biblioteka/W/WE/kep/orędzie-niem_18111965.html) [31 Tetor 2019].

një fotografi të një mijë vjetëve të fqinjësisë polako-gjermane, e cila prej shekujsh kishte qenë kryesisht e mirë. Ky interpretim i historisë polako-gjermane ishte krejtësisht i ndryshëm nga ligjërimi i partisë komuniste (njëmijë vjet luftë) dhe kulmonte me fjalët: “Ne falim dhe kërkojmë falje”.<sup>9</sup> Këto fjalë ishin një shock për shoqërinë polake, e cila ishte tërësisht e papërgatitur për një mesazh të tillë. Si përgjigje, udhëheqja komuniste ndërmori një luftë kundër kishës katolike, e cila ishte më e egra që prej periudhës staliniste. Vështirësia e situatës së peshkopëve polakë u rrit më tej duke qënë se përgjigja e peshkopëve katolikë gjermanë ishte pothuajse me gjysëm zemre. Ata donin të shmangnin një pozicionim të qartë ndaj kufirit të ri polako-gjerman për shkak të marrëdhënieve të ngushta me CDU/CSU-në dhe organizatat e të dëbuarve. Qëndrimi i tyre ndryshoi pas ratifikimit në 1972 të traktatit në të cilin Republika Federale njohu kufirin e ri polako-gjerman.

Ndërsa memorandumit protestant në Gjermani çoi në një ndryshim të qëndrimit ndaj Polonisë në një mënyrë politikisht të rëndësishme, letra e peshkopëve polakë filloi në Poloni, gjatë periudhës komuniste, një ndryshim në qëndrimin ndaj Gjermanisë vetëm midis një grupi të vogël intelektualësh katolikë. Në fillim të viteve '90, shumica e polakëve dhe gjermanëve shprehin antipati të ndërsjelltë në sondazhet e opinionëve.<sup>10</sup> Sidoqoftë, që nga fundi i viteve 1960, takimet e anëtarëve të “Klubeve të Inteligjencës Katolike” polake dhe intelektualëve të Gjermanisë Perëndimore dhe Lindore, veçanërisht të lidhura me kishat protestante dhe katolike, ishin në fillim të një dialogu autentik midis një pakice të vogël por me ndikim, e cila u njoh me mënyrën e të menduarit të palës tjetër. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për partnerët polakë, pasi midis anëtarëve të tyre protagonistë si Tadeusz Mazowiecki apo Władysław Bartoszewski morën pozicionet kryesore politike pas vitit 1989.

Një hap i rëndësishëm për pajtimin polako-gjerman ishte nënshkrimi në 1970 i traktatit në të cilin Republika Federale e Gjermanisë pranoi kufirin ekzistues polako-gjerman. Në planin afatgjatë, më e rëndësishme ishte, gjithsesi, ndikimi i gjunjëzimit simbolik të Brandt-it në Varshavë.<sup>11</sup> Pas ratifikimit të këtij traktati në 1972, u instauruan marrëdhënie diplomatike midis Republikës Federale dhe Polonisë. Sidoqoftë, një pikë e dobët e Ostpolitik-ut u bë e dukshme kur u themelua Solidarność në Poloni në 1980. Ndërsa qëllimet e Solidarność-ut korrespondonin me vlerat politike të elitave politike të Gjermanisë Perëndimore, problem ishte që partnerët e Ostpolitik-ut ishin qeveri të cilat nuk gëzonin legjitimitet demokratik. Sa më i fortë po bëhej Solidarność, aq më shumë partnerët komunistë të Ostpolitik-ut po humbnin bazën e fuqisë së tyre politike. Qëndrimi politik i qeverisë gjermane ishte mjaftueshëm ambivalent kur ligji ushtarak hyri në fuqi në Poloni në dhjetor 1981 dhe Solidarność-u u shtyp. Në kontrast me të, reagimi i shoqërisë

---

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> Centrum Badań Opinii Społecznej, “Stosunek do innych narodów”, [https://cbos.pl/SPISKOM.POL/2019/K\\_017\\_19.PDF](https://cbos.pl/SPISKOM.POL/2019/K_017_19.PDF) [31 Tetor 2019].

<sup>11</sup> “Układ między Polską Rzeczpospolitą Ludową a Republiką Federalną Niemiec o podstawach normalizacji ich wzajemnych stosunków z 7 grudnia 1970 r.”, [https://pl.wikisource.org/wiki/Uk%C5%82ad\\_mi%C4%99dzy\\_Polsk%C4%85\\_Rzecz%C4%85pospolit%C4%85\\_Ludow%C4%85\\_a\\_Republik%C4%85\\_Federaln%C4%85\\_Niemiec\\_o\\_podstawach\\_normalizacji\\_ich\\_wzajemnych\\_stosunk%C3%B3w\\_z\\_7\\_grudnia\\_1970\\_r](https://pl.wikisource.org/wiki/Uk%C5%82ad_mi%C4%99dzy_Polsk%C4%85_Rzecz%C4%85pospolit%C4%85_Ludow%C4%85_a_Republik%C4%85_Federaln%C4%85_Niemiec_o_podstawach_normalizacji_ich_wzajemnych_stosunk%C3%B3w_z_7_grudnia_1970_r) [31 Tetor 2019].

gjermane ishte dërrmues. U organizuan qindra transporte ushqimesh dhe mallrash të tjerë për nevojat themelore, miliona pako u dërguan në Poloni, e cila po përjetonte një krizë të rëndë furnizimi. Shumë polakë u befasuan nga shtrirja e ndihmës spontane dhe nisën t'a perceptojnë shoqërinë gjermane në një mënyrë të re.

Një kapitull i ri në marrëdhëniet polako-gjermane u hap kur Solidarność mposhti regjimin komunist në 1989. Kryeministri Mazowiecki deklaroi në programin e tij të qeverisjes se Polonia dëshironte të krijonte marrëdhënie polako-gjermane sipas modelit të marrëdhënieve gjermano-frënge. Dukej simbolike që muri i Berlinit ra në mbrëmjen e ditës së parë të vizitës, të përgatitur me kujdes, të kancelarit Helmut Kohl në Poloni. Gjatë kësaj vizite u zhvillua "mesha e pajtimit" historik në Krzyżowa. Kryetarët e qeverive polake dhe gjermane, Mazowiecki dhe Kohl, i ofruan njëri-tjetrit "shenjën e paqes".

Më pak se një vit më vonë, Gjermania u bashkua dhe u nënshkruan dy traktate themelore për marrëdhëniet polako-gjermane,<sup>12</sup> që konfirmuan kufirin ekzistues polako-gjerman dhe vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit, duke përcaktuar bazën ligjore për bashkëpunimin e ardhshëm midis shoqërive civile nga të dyja anët. U vendos një bashkëpunim intensiv midis bashkive dhe rajoneve përgjatë kufirit të përbashkët nga Deti Baltik deri në Republikën Çeke. Aktualisht, ekzistojnë pothuajse 1000 partneritete shumë të gjalla midis qyteteve polake dhe gjermane. Zyra e Rinisë Polako-Gjermane, e themeluar në vitin 1991 sipas modelit gjermano-frëng, ndërkohë ka kontribuar në bashkëveprimin e rreth 3 milion të rinjve polakë dhe gjermanë.<sup>13</sup> Ekziston një shkëmbim intensiv midis shkollave dhe një bashkëpunim i ngushtë midis universiteteve, OJQ-ve dhe think tankeve të mbështetura nga qeveritë qendrore dhe ato lokale.

Përkujtimi i përbashkëti i ngjarjeve të rëndësishme nga politikanë të lartë polakë dhe gjermanë ishin të rëndësishme edhe për procesin e pajtimit. Gjatë pjesëmarrjes së tij në përkujtimin e 50-vjetorit të kryengritjes së Varshavës në 1994, Presidenti Federal Roman Herzog i kërkoi popullit polak falje për vuajtjet që i shkaktuan gjermanët gjatë luftës. Ministri polak i Punëve të Jashtme, Władysław Bartoszewski, më vonë gjatë fjalës së tij në Parlamentin gjerman, e quajti fjalimin e Herzog-ut "përgjigjen e vërtetë dhe të shumëpritur" për letrën e peshkopëve polakë të vitit 1965 dhe ai shprehu simpatinë ndaj "fatit personal dhe vuajtjes së gjermanëve të pafajshëm" që humbën atdheun e tyre.<sup>14</sup> Gjatë një ceremonie të përbashkët inaugurimi të një ekspozite në Berlin me rastin e 75 vjetorit të kryengritjes së Varshavës, presidentët Komorowski dhe Gauck ndanë në prani të veteranëve të kryengritjes fjalë prekëse duke treguar se si përkujtimi i përbashkët i ngjarjeve tragjike mund t'i afrojë edhe sot polakët dhe gjermanët më pranë njëri-tjetrit.

---

<sup>12</sup> "Traktat między Rzeczpospolitą Polską a Republiką Federalną Niemiec o potwierdzeniu istniejącej między nimi granicy, podpisany w Warszawie dnia 14 listopada 1990 r."

"Traktat między Rzeczpospolitą Polską a Republiką Federalną Niemiec o dobrym sąsiedztwie i przyjaznej współpracy z 17.06.1991 r."

<sup>13</sup> Polsko-Niemiecka Współpraca Młodzieży, <https://www.pnwm.org/o-pnwm/>.

<sup>14</sup> Ziemer K., From Hatred to Friendly Cooperation: Poland and Germany after the Second World War, in The India-Pakistan Reconciliation and other Experiences in Post-conflict Management, ed. Gilles Boquerat and Richard Asbeck, Paris 2009, fq.115.

Gjithashtu edhe fjalimet e presidentëve Duda dhe Steinmeier në Wieluń dhe Varshavë në të njëjtin rast përkujtimor në 2019 rezonuan shumë mirë për publikun polak.

## **Përballja me historinë - mësimet e nxjerra**

Ballafaqimi me historinë është pjesë përbërëse e një procesi të suksesshëm pajtimi dhe nisja e diskutimit të sigurtë të historianëve nga të dyja palët për tema të vështira të historisë së përbashkët është një hap i rëndësishëm për lehtësimin e tij. Përveç diskutimit të historianit me qëllim vendosjen e tregimeve të paanshme për ngjarjet historike, duhet të ndëshkohen krimet e kryera në emër të ish-diktaturës. Për shkak të denazifikimit të pamjaftueshëm midis prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve, përndjekja sistematike e krimeve të luftës filloi në Gjermani vetëm në vitet 1960, kur ishte tepër vonë për shumë kriminelë luftime që të çoheshin përpara një gjykate. Gjithsesi, historianët polakë dhe gjermano-perëndimorë në 1972 themeluan një komision të përbashkët për tekstet shkollorë në lidhje me historinë dhe gjeografinë, i cili funksionon edhe sot.<sup>15</sup> Një Institut Historik gjerman në Varshavë u krijua në 1993 dhe një ekuivalent polak në Berlin në 2006.<sup>16</sup> Bashkëpunimi midis historianëve polakë dhe gjermanë u bë shumë intensiv dhe i frytshëm. Qindra libra u botuan së bashku nga autorë polakë dhe gjermanë.<sup>17</sup>

Pikëpamja për historinë në shoqëri, gjithsesi, përcaktohet jo vetëm nga historianët, por edhe nga politikanët, media dhe narrativa familjare. Historia shpesh përdoret (dhe keqpërdoret) në konfliktet politike. Në fillim të viteve 2000, u shfaq një valë publikimesh, dokumentimesh dhe filmash të përqendruar tek fati i gjermanëve në fund të Luftës së Dytë Botërore, që irritoi publikun polak. Gjithashtu, në 2000, një fondacion i krijuar kryesisht nga funksionarë të Federatës së të Dëbuarve (BdV)<sup>18</sup> kërkoi krijimin e Qendrës kundër Dëbimeve (ZgV) në Berlin.<sup>19</sup> Në Poloni kjo u perceptua si një rishkrim i historisë nga gjermanët, duke i shndërruar autorët në viktime. Kryetarja e BdV-së, Erika Steinbach (për shumë vite deputete e CDU-së në Bundestag, sot afër AfD-së), një ekstremiste pak e njohur në Gjermani, mbizotëroi për disa vjet në titujt e mediave polake me deklarata të diskutueshme dhe rëndoi tek marrëdhëniet polako-gjermane. Në Gjermani kjo vështirë se u vu re. Situata u përkeqësua më tej me krijimin e "Kujdestarisë Prusiane" nga ekstremistë të BdV-së, që kërkonin kthimin ose kompensimin e pasurive të patundshme të ish-pronarëve gjermanë në territoret që tani i përkasin Polonisë. Kjo shkaktoi frikë midis miliona polakëve. "Kujdestaria Prusiane" e shtroi këtë çështje edhe përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në 2006 dhe humbi në 2008.

<sup>15</sup> Wspólna Polsko-Niemiecka Komisja Podręcznikowa, <http://deutsch-polnische.schulbuchkommission.de/pl/strona-glowna.html>.

<sup>16</sup> Deutsches Historisches Institut Warschau, Niemiecki Instytut Historyczny w Warszawie, <https://www.dhi.waw.pl/pl.html>, Centrum Badań Historycznych PAN, Das Zentrum für Historische Forschung Berlin der Polnischen Akademie der Wissenschaften, <http://www.cbh.pan.pl/de>.

<sup>17</sup> Publikimi në katër vëllime Polsko-niemieckie miejsca pamięci („Vendet e kujtesës polako-gjermane”) përfaqëson një nga shembujt më të spikatur të bashkëpunimit midis historianëve polakë dhe gjermanë.

<sup>18</sup> Bund der Vertriebenen, [www.bund-der-vertriebenen.de](http://www.bund-der-vertriebenen.de).

<sup>19</sup> Zenter gegen Vertreibungen, [www.z-g-v.de](http://www.z-g-v.de).

Qeverisja e koalicionit të udhëhequr nga Ligji dhe Drejtësia (PiS), një parti populiste kombëtare, kontribuoi në rritjen e tensioneve midis Varshavës dhe Berlinit në 2005-2007. Në 2007 dhe 2015, kur PiS ishte në opozitë, marrëdhëniet dypalëshe polako-gjermane u përmirësuan ndjeshëm, megjithëse Jarosław Kaczyński, udhëheqësi i opozitës, mbeti fuqishëm kritik për pajtimin me Gjermaninë, duke e paraqitur atë si një kthesë jo të sigurtë.<sup>20</sup> Në 2015, PiS u kthye në pushtet dhe themeloi qeverinë e parë njëpartiake në historinë e Polonisë. Transformimi i sistemit politik të Polonisë nën sundimin e PiS, nga demokracia liberale e bazuar në parimin e kontrolleve dhe balancave në sistemin "maxhoritar" të dominuar nga partia në pushtet duke minuar sundimin e ligjit në vend, ndezi kritika të ashpra nga BE-ja dhe një përkeqësim të paparë të marrëdhënieve midis Polonisë dhe aktorëve të ndryshëm të BE-së, përfshirë Gjermaninë. Si përgjigje, PiS forcoi përdorimin e argumenteve historike që evokojnë Luftën e Dytë Botërore në politikën e saj ndaj Gjermanisë, e cila u përkthye gjithashtu në një regres në pajtimin polako-gjerman. Kaczyński e akuzoi Gjermaninë për përpjekje për të zvogëluar përgjegjësinë gjermane për krimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe për të zhvendosur fajin tek kombet e tjera, përfshirë polakët,<sup>21</sup> duke sugjeruar gjithashtu se Gjermania nuk ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga Lufta e Dytë Botërore.<sup>22</sup>

Si përgjigje për propozimin e BE-së për të kufizuar alokimin e fondeve e saj ndaj Polonisë, bazuar tek problemet me sundimin e ligjit, qeveria polake ngriti çështjen e dëmshpërblimeve gjermane për krimet dhe shkatërrimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore. Menjëherë pas zgjedhjeve në 2015, PiS themeloi komitetin për dëmshpërblime në parlamentin polak. Gjithsesi, Polonia nuk ka prezantuar ende një kërkesë zyrtare për dëmshpërblime dhe për palën gjermane çështja është mbyllur për shkak të traktateve ndërkombëtare ekzistuese, të cilat janë nënshkruar që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Sidoqoftë, çështja vazhdon të ngrihet nga autoritetet polake. Për shembull, në një intervistë me tabloidin gjerman Bild, Presidenti i Polonisë Andrzej Duda tha se marrëdhëniet polako-gjermane janë një model shembullor i pajtimit, por shtoi se pagimi i dëmshpërblimeve të Luftës së Dytë Botërore për Poloninë është "një çështje përgjegjësie

---

<sup>20</sup> Kaczyński deklaroi që Gjermania dëshiron të nënshtrijë Poloninë sepse ajo ëndërron territoret e humbura pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas tij, Gjermania një ditë mund të realizojë ëndrrat e saja dhe "ne do të zgjohemi në një Poloni më të vogël". Prandaj, përmes kësaj lenteje, investimet gjermane në Poloninë perëndimore përbëjnë një kërcënim për sigurinë polake. Kaczyński gjithashtu akuzoi shumë herë një pjesë të konsiderueshme të elitës kulturore polake dhe opozitën politike se janë kolona e pestë në listën e pagave gjermane. Në ligjërimin e Ligj dhe Drejtësi, Gjermania është paraqitur shpesh si një aleat tradicional i Rusisë duke u përpjekur së bashku me Moskën për të ndarë Poloninë, sikurse ndodhi disa herë në të shkuarën (veçanërisht duke kujtuar paktin Ribbentrop-Molotov). Kaczyński e quajti shumë herë vendin e tij një godinë gjermano-ruse. Shiko Jarosław Kaczyński, *Polska naszych marzeń*, Warszawa 2011.

<sup>21</sup> "Politika gjermane e kujtesës [është] zhvilluar për 70 vite në një mënyrë shumë konsistente, në mënyrë që të reduktojë fajin e Gjermanisë dhe në të njëjtën kohë të bindë botën se Gjermania është totalisht ndryshe." "Prezes PiS: Stuprocentową odpowiedzialność za Holokaust ponoszą Niemcy", tvpinform.com, [www.tvp.info/37865894/prezes-pis-stuprocentowa-odpowiedzialnosc-za-holokaust-ponosza-niemcy](http://www.tvp.info/37865894/prezes-pis-stuprocentowa-odpowiedzialnosc-za-holokaust-ponosza-niemcy), [31 Tetor 2019].

<sup>22</sup> Duke aluduar për Gjermaninë, Kaczyński tha, "Duhet të mbahet mend se ku dhe në cilën kulturë ekzistojnë kërcënimet më të mëdha për Europën, botën dhe rendin moral." "Jarosław Kaczyński o pogromie w Białymstoku: to była wina państwa niemieckiego i narodu niemieckiego", Wirtualna Polska, [www.wiadomosci.wp.pl/jaroslaw-kaczynski-o-pogromie-w-bialymstoku-to-byla-wina-panstwa-niemieckiego-i-narodu-niemieckiego-6027392472183425a](http://www.wiadomosci.wp.pl/jaroslaw-kaczynski-o-pogromie-w-bialymstoku-to-byla-wina-panstwa-niemieckiego-i-narodu-niemieckiego-6027392472183425a), [31 Tetor 2019].

dhe morali".<sup>23</sup> Sipas sondazheve të opinioneve, kërkesa për dëmshpërblime mbështetet nga shumica e polakëve, ndërsa gjermanët e refuzojnë vendosmërisht atë.<sup>24</sup>

## Konkluzione

Pajtimi polako-gjerman i nisur më shumë se 50 vjet më parë, arriti një përparim spektakolar veçanërisht duke marrë parasysh barrën e krimeve të mëdha të kryera nga Gjermania naziste kundër polakëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Perceptimi i ndërsjelltë në rritje i polakëve dhe gjermanëve ka kontribuar tek pajtimi dhe ndër vite është përmirësuar ndjeshëm. Gjithsesi, sondazhet e opinioneve tregojnë se ekziston ende hendeku midis një qëndrimi më pozitiv të polakëve ndaj gjermanëve sesa anasjelltas.<sup>25</sup> Kjo është ndoshta për shkak të faktit se polakët njohin më mirë me Gjermaninë sesa anasjelltas. Sot spiranca më e rëndësishme e pajtimit janë – përpos një shkëmbimi ekonomik në rritje të vazhdueshme - marrëdhëniet intensive midis dy shoqërive civile. Kjo bën që një përmbysje vendimtare e pajtimit ka shumë pak të ngjarë. Për shkak të këtij suksesi, pajtimi polako-gjerman mund të shërbejë si një burim frymëzimi për Ballkanin Perëndimor. Sidoqoftë, duhet pranuar se një ndryshim thelbësor midis trashëgimisë së historisë në çështjen polako-gjermane dhe ekuivalentëve të Ballkanit Perëndimor e kufizon rëndësinë e pajtimit midis polakëve dhe gjermanëve për kombet e Ballkanit Perëndimor. Paradoksalisht trashëgimia e luftërave që ndodhën në shekullin e 20-të në Ballkanin Perëndimor, dukshëm më e komplikuar se historia moderne polako-gjermane, mund t'a bëjë procesin e pajtimit më të vështirë dhe sfidues.

Aktualisht një mësim edhe më i rëndësishëm që kombet e Ballkanit Perëndimor mund të nxjerrin nga pajtimi polako-gjerman është brishtësia e tij dhe ekspozimi ndaj efekteve negative të marrëdhënieve ndërshtetërore dypalëshe dhe zhvillimeve të brendshme politike. Në të vërtetë marrëdhëniet polako-gjermane në nivel qeveritar janë përkeqësuar gjatë viteve të fundit, duke kontribuar në një regres të caktuar të pajtimit. Çështja e përballjes me një të kaluar të vështirë po shfaqet sërish - siç tregon rasti i kërkesave për dëmshpërblim - si një nga çështjet kryesore të përçarjes. Për më tepër, përkeqësimi i marrëdhënieve dypalëshe rezultoi gjithashtu në uljen e ndërsjellë të simpatisë midis të dy kombeve, megjithëse deri më tani në një shkallë më të vogël për Gjermaninë. Niveli i arritur i mirëkuptimit midis shoqërive polake dhe gjermane nuk konsiderohet si diçka një herë e përgjithmonë. Ai është një detyrim që duhet të vazhdojë çdo ditë dhe mund të rrezikohet kur politikanët, që luajnë me zjarrin nationalist për interesa politike afatshkurtra, nënvizojnë kujtimet negative të së kaluarës.

---

<sup>23</sup> "Wir werden eine Rechnung vorlegen!", Polens Präsident Andrzej Duda im Bild-Interview", Bild, [www.bild.de/bild-plus/politik/ausland/politik-ausland/jahrestag-des-zweiten-weltkriegs-polen-praesident-duda-im-bild-interview-64306980.view=conversionToLogin.bild.html](http://www.bild.de/bild-plus/politik/ausland/politik-ausland/jahrestag-des-zweiten-weltkriegs-polen-praesident-duda-im-bild-interview-64306980.view=conversionToLogin.bild.html), [31 Tetor 2019].

<sup>24</sup> CBOS, "Postrzeganie II wojny światowej i poparcie dla domagania się reparacji od Niemiec", [www.cbos.pl/SPISKOM.POL/2019/K\\_113\\_19.PDF](http://www.cbos.pl/SPISKOM.POL/2019/K_113_19.PDF), [31 Tetor 2019], "Große Mehrheit gegen Reparationen für Polen und Griechenland", Die Zeit, [www.zeit.de/news/2019-08/30/grosse-mehrheit-gegen-reparationen-fuer-polen-und-griechenland](http://www.zeit.de/news/2019-08/30/grosse-mehrheit-gegen-reparationen-fuer-polen-und-griechenland), [31 Tetor 2019].

<sup>25</sup> Łada A., "Polaków lubi tylko jedna trzecia Niemców", Polityka, [www.polityka.pl/tygodnikpolityka/kraj/1751244,1,polakow-lubi-tylko-jedna-trzecia-niemcow.read](http://www.polityka.pl/tygodnikpolityka/kraj/1751244,1,polakow-lubi-tylko-jedna-trzecia-niemcow.read), [31 Tetor 2019].



# Divorci i Kadifenjtë: Shpërbërja e Çekosllovakisë si një frymëzim për Ballkanin Perëndimor

*Tatiana Chovancová, Jana Juzová*

## Hyrje

Shembulli i shpërbërjes së Çekosllovakisë në fillim të viteve 1990, i ashtuquajtur edhe "Divorci i Kadifenjtë", shpesh shërben si një model i shpërbërjes paqësore të një shteti të përbashkët. Ndërsa konteksti i shtetit të përbashkët çekoslovak dhe ndarja e tij, si dhe historia e përbashkët e çekëve dhe sllovakëve, janë shumë të ndryshme nga ato të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për shkak të ndarjes së saj paqësore dhe të mirë menaxhuar, si dhe të zbatimit dhe vendosjes së marrëdhënieve miqësore "përtej standardeve" pas shpërbërjes, - për të cilat Çekosllovakia studiohet si një shembull model krahasuar me shpërbërjet e shteteve të tjera - do të ishte e pamundur që të mos përfshihej në mesin e rasteve të studiuara në këtë projekt.

Ekziston një ndjenjë e përgjithshme në Republikën Çeke dhe në Sllovaki që marrëdhëniet aktuale janë më të mira sesa ato në kohën e shtetit të përbashkët, ndonëse sipas sondazheve të fundit shumica e çekëve dhe sllovakëve besojnë se marrëdhëniet nuk kanë ndryshuar shumë.<sup>26</sup> Të dy shtetet i drejtohen njëri-tjetrit si aleati më i ngushtë dhe një partner natyror. Vizitat midis përfaqësuesve çekë dhe sllovakë janë shumë të shpeshta dhe miqësore (për shembull si pjesë e traditës, vizita e parë jashtë e presidentëve të sapozgjedhur të të dy shteteve zhvillohet përkatësisht në Republikën Çeke ose në Sllovaki).

Gjithsesi, konteksti i kësaj ndarjeje, si dhe çështjet dhe zhvillimet që çojnë drejt saj, shpesh mbeten të lëna mënjanë. Ndërsa në ditët e sotme ka një mungesë të dukshme të çështjeve konfliktuale midis çekëve dhe sllovakëve, jeta në shtetin e përbashkët ishte larg prej të qënurit ideale dhe barra e historisë luajti gjithashtu rolin e saj. Çekosllovakia lindi pas Luftës së Parë Botërore me rënien e Perandorisë Austro-Hungareze, si një produkt i përbashkët i çekëve dhe sllovakëve që u çliruan nga ish-sundimtarët e tyre dhe si një mënyrë për të fituar më shumë forcë dhe njohje ndërkombëtare në krahasim me shtetet individuale më të vogla. Pas Marrëveshjes së Mynihut dhe pushtimit nazist të Çekosllovakisë, shteti i përbashkët pësoi krizën e parë, pasi pjesa çeke e shtetit u shndërrua në një territor të okupuar, ndërsa në Sllovaki ("Shteti Sllovak") u vendos një regjim kolaboracionist. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe disfatës së regjimeve naziste dhe fashiste në Europë, Çekosllovakia u rivendos, këtë herë nën një regjim komunist të kontrolluar nga Bashkimi Sovjetik.

---

<sup>26</sup> Centrum pro výzkum veřejného mínění, "Tisková zpráva: Rozdělení Československa: 25 let od vzniku samostatné ČR a SR", [https://cvvm.soc.cas.cz/media/com\\_form2content/documents/c2/a4464/f9/po171205.pdf](https://cvvm.soc.cas.cz/media/com_form2content/documents/c2/a4464/f9/po171205.pdf), [30 Tetor 2019].

Ankesat ekzistuan edhe brenda shtetit të parë çekoslovak - sllovakët fajësuan çekët për mungesë interesi ndaj Sllovakisë, përqendrimin e industrive thelbësore në tokat çeke dhe ndjenjën e përjashtimit nga vendimmarrja që zhvillohej në Pragë. Nga ana tjetër, në pjesën çeke të shtetit, disa e konsideruan Sllovakinë si pjesën më të dobët që kishte nevojë për ndihmë dhe që ndalonte progresin e tyre ekonomik. Ndërsa okupimi nazist përfaqësoi për sllovakët një shans unik për të pasur dhe për të qeverisur shtetin e tyre kombëtar për herë të parë në histori, për palën çeke krijimi i Shtetit Sllovak u perceptua si oportunitizëm pa asnjë solidaritet me vëllezërit çekë.

Në shtetin e dytë të përbashkët midis çekëve dhe sllovakëve këto ankesa të ndërsjellta u shtypën, kryesisht nga sundimi i rreptë komunist i kontrolluar nga Moska. Vetëm pas Revolucionit të Kadifenjtë në 1989 dhe vendosjes së qeverisë demokratike, u vunë re dallimet e ndërsjellta dhe vizionet kontradiktore midis çekëve dhe sllovakëve, të mbështetura fuqimisht nga personalitetet dhe botëkuptimet e elitave të reja politike të të dyja palëve. Për sllovakët, rënia e komunizmit krijoi një mundësi për emancipim kombëtar dhe rritje të kërkesës për një zë më të fortë për problemet dhe të ardhmen e tyre. Nga ana tjetër, çekët dëshironin një shtet të përbashkët çekoslovak, të konsoliduar së brendshmi dhe të bashkuar së jashtmi.

Kriza e parë u shfaq kur u hap çështja e ndryshimit të emrit, duke hequr fjalën "socialist" nga emërtimi zyrtar i shtetit, dhe duke krijuar Republikën Çekoslovakë. Sllovakët e panë këtë si një mundësi për të mundësuar një ndryshim tjetër - duke futur një vijë ndarëse (-) në fjalën Çekoslovakë (d.m.th. Republika Çeko-Sllovake), kthyen kështu emrin e republikës së parë nga 1918 deri në 1920, duke theksuar natyrën federale të shtetit dhe barazinë midis dy entiteteve. Ndërsa kjo mund të duket si një çështje e vogël, për çekët dhe sllovakët kjo mosmarrëveshje krijoi një diskutim shumë serioz që rezultoi në një krizë të tejzgjatur për disa muaj. Zgjidhja e mëposhtme u ofrua nga Parlamenti Çekoslovak: fjala Federale iu shtua emërimit (d.m.th. Republika Federale Çekoslovakë) dhe emri u shkrua pa vizën ndarëse midis fjalës Çeke dhe asaj Sllovake. Përfundimisht, kjo zgjidhje ishte e papranueshme për elitat politike sllovake, si dhe emërtimi përfundimtar u vendos të ishte Republika Federale Çeke dhe Sllovake, duke theksuar edhe më qartë barazinë midis çekëve dhe sllovakëve.

Këto pikëpamje divergjente u bënë edhe më të qarta pas zgjedhjeve të përgjithshme të 1992. Në Republikën Çeke, zgjedhjet u fituan nga Partia Demokratike Qytetare (ODS) e udhëhequr nga Václav Klaus, ndërsa në Sllovaki ishte më e suksesshme partia nacionaliste Lëvizja për Sllovakinë Demokratike (HZDS), e udhëhequr nga Vladimír Mečiar. Të dy udhëheqësit u bënë kryeministra në qeveritë kombëtare përkatëse. Dhe ndërsa i pari advokonte për privatizim të shpejtë dhe transformim ekonomik të përgjithshëm duke ruajtur modelin e shtetit federal, i dyti dëshironte një transformim ekonomik më të ngadaltë, me ndërhyrje të shtetit, dhe bënte thirrje për një model konfederal. HZDS ndoqi një model të papajtueshëm të sovranitetit dhe personalitetit juridik slllovak, ndërsa qëndroi në një shtet të përbashkët me çekët. Çekët nga ana tjetër parashikonin një federatë me një qeveri të fortë federale.



## **Praktikat më të mira dhe mësimet e marra**

Në përvojën mjaftueshmërisht pozitive të shpërbërjes së shtetit çekoslovak, pa prezencë të dhunës, mund të identifikohen disa faktorë që mbështetën një procesin relativisht të qetë, pavarësisht rezultatit final. Gjithsesi, në varësi edhe të shumë karakteristikave të tjera të situatës në tërësi, krahasueshmëria e rastit çekoslovak me raste të tjera, si p.sh. shpërbërja e Jugosllavisë, është e kufizuar. Gjithsesi, disa përfundime të rëndësishme mund të nxirren nga përvoja çekoslllovakë.

## **Vendim politik pa një referendum**

Paradoksi është që ndonëse votuan shumë ndryshe, shumica e çekëve dhe sllovakëve dëshironin të qëndronin në një shtet të unifikuar.<sup>27</sup> Shpërbërja e dakordësuar nga liderët e zgjedhur mund të interpretohet si një pasojë e paqëllimshme në atë kohë. Çekët dhe sllovakët kishin ide shumë të ndryshme rreth natyrës së transformimit ekonomik dhe politik të shtetit dhe vendosjes së marrëdhënieve të ardhshme brenda Çekosllovakisë, të cilat nuk ishin aq të pajtueshme sa të mund të realizoheshin në një shtet të vetëm.

Nga marrëveshja e shpejtë midis kryeministrave Klaus dhe Mečiar dhe drejtimin që morën më pas shtetet e veçuara nën udhëheqjen e tyre, vërehet se personalitetet dhe motivimet e tyre kanë kontribuar në fundin e Çekosllovakisë. Të dy burrat kishin një vizion të fortë për të ardhmen e vendit të tyre (të ndryshëm nga njëri-tjetri) dhe me sa duket e kuptuan se, në një Çekoslovakë të bashkuar secili prej tyre kishte më pak fuqi politike për të ndjekur këtë vizion. Por asnjë prej tyre nuk e kërkoi haptazi ndarjen në fillim dhe deri më sot të dy thonë se ishte pala tjetër që nxiti ndarjen.

Siç u përmend më lart, sondazhet e opinioneve të kryera në atë kohë treguan se shumica e qytetarëve në të dy pjesët e Çekosllovakisë nuk dëshironin shpërbërjen. Elitat politike ishin të vetëdijshme për këtë situatë dhe kështu shmangën mbajtjen e një referendumi karshi kërkesës së përgjithshme për një të tillë (mbi 1 milion çekoslllovakë nënshkruan një petition që kërkonte mbajtjen e një referendumi<sup>28</sup>). Për shkak të mungesës së mundësive për qytetarët që të kishin zë në vendimin për të ardhmen e Çekosllovakisë, ky vendim ndonjëherë kritikohet si i paligjshëm. Sidoqoftë, përgjigjja e udhëheqësve që qëndronin pas ishte se qytetarët treguan preferencat e tyre përmes zgjedhjeve që sollën në pushtet Klaus-in dhe Mečiar-in, dhe kështu nuk nevojitej një referendum. Nga intervistat e mëvonshme të Klaus-it del qartë që ata ishin të shqetësuar se rezultatet e referendumit

---

<sup>27</sup> Centrum pro výzkum veřejného mínění, Sociologický ústav AV ČR, "Občané k rozdělení Československa před 10 lety", [https://cvvm.soc.cas.cz/media/com\\_form2content/documents/c2/a239/f9/100151s\\_PO21227.pdf](https://cvvm.soc.cas.cz/media/com_form2content/documents/c2/a239/f9/100151s_PO21227.pdf), [30 Tetor 2019] dhe "Rozpad ČSFR: Většina lidí si ho nepřála", Magazín M, <https://www.em.muni.cz/tema/3272-rozpad-csfr-vetsina-lidi-si-ho-neprala>, [30 Tetor 2019].

<sup>28</sup> Engelberg S., Czechoslovakia Breaks in Two, To Wide Regret, The New York Times, <https://www.nytimes.com/1993/01/01/world/czechoslovakia-breaks-in-two-to-wide-regret.html?pagewanted=all>, [30 Tetor 2019] dhe Patočka, J., Changing our country's name to Czechia won't solve the problems we face, The Guardian, <https://www.theguardian.com/commentisfree/2016/apr/18/czechia-name-change-czech-republic-problems-people-government>, [30 Tetor 2019].

nuk do të mbështesnin ndarjen në të paktën një pjesë të federatës dhe kështu kjo çështje do të komplikohet edhe më tej.

Sidoqoftë, skena politike sllovaqe ishte edhe më e ndarë në këtë temë. Me përjashtim të Lëvizjes (jo shumë domethënëse) për Mirëkuptim Çekoslovak, të gjithë subjektet donin të paktën një federatë. Publiku Kundër Dhunës (VPN), që kishte fituar shumicën në zgjedhjet e përgjithshme sllovaqe në 1990, kërkoi një "federatë partneriteti". Më tej gjendej Lëvizja Demokratike Kristiane (KDH) me liderin e saj Ján Čarnogurský, që shërbeu si kryeministër sllovak nga 1991 deri në 1992, dëshironte një model disi më të butë sesa një federatë dhe sipas fjalëve të tij "një yll në flamurin e BE-së për Sllovakinë".<sup>29</sup> HZDS bëri thirrje për një konfederatë dhe pa habi, Partia Kombëtare Sllovaqe (SNS) kërkoi pavarësi të plotë. Kjo tregon qartë se edhe brenda njërit prej kombeve, opinionet mbi të ardhmen e Çekoslovakisë ishin të ndara.

Nga ana tjetër, nga pala çeke elitat politike, përveç Kryeministrit, ishin shumë më të bindura për ruajtjen e federatës, me ndjenja të forta karshi Çekoslovakisë, duke përfunduar me dorëheqjen e Václav Havel-it nga posti i Presidentit çekoslovak kur u arrit marrëveshja mes dy kryeministrave për shpërbërjen. Gjithashtu, partitë e tjera politike dëshironin të ruanin federatën, ndonëse ata ndryshonin në shkallën e gatishmërisë për t'iu dorëzuar kërkesave sllovaqe, dhe Václav Klaus-i shpesh u kritikua prej tyre për vulosjen e fatit të shtetit të përbashkët. Në përgjithësi, mund të thuhet se çekët identifikoheshin shumë më tepër me shtetin çekoslovak sesa sllovakët dhe themelimi i Çekoslovakisë së pavarur në 1918 ka një vend më domethënës dhe sentimental në historinë e tyre.

### **Ndarja teknike e mirë-menaxhuar u perceptua si e pranueshme nga të dyja palët**

Një faktor i rëndësishëm që kontribuon në tërësinë e marrëdhënieve të mira reciproke midis dy shteteve të reja pas ndarjes ishte vetë natyra e ndarjes teknike. Edhe pse në fillim pala çeke dhe sllovaqe kishin preferenca të ndryshme në formulën sipas së cilës do të ndahej prona çekoslllovaqe, përfundimisht negociatat u përmyllën me një marrëveshje për ndarjen 2:1 midis çekëve dhe sllovaqeve, sipas madhësisë së popullsisë dhe territorit.<sup>30</sup>

Një faktor tjetër që ndihmoi në ndarjen e butë ishte homogjeniteti relativisht i lartë i popullatës në të dy pjesët e federatës, i mbështetur më tej nga nënshkrimi i një numri marrëveshjesh, përfshirë ato që mundësonin lëvizjen e lirë të njerëzve dhe tregtinë. Të gjithë këta faktorë e bënë më të lehtë për popullsinë që të përshtatej me rrethanat e reja dhe të pengonte arsyet e rezistencës nga qytetarët.

---

<sup>29</sup> "Rozhovor prezidenta republiky o rozdělení Československa v knize „Jak praskaly švy“,“ <https://www.klaus.cz/clanky/2986>. [30 Tetor 2019].

<sup>30</sup> Česko-slovenský rozvod. Spory o majetek trvaly sedm let, porcovaly se vlaky i letadla, *Český rozhlas*, <https://radiozurnal.rozhlas.cz/cesko-slovensky-rozvod-spory-o-majetek-trvaly-sedm-let-porcovaly-se-vlaky-i-7183253>, [30 Tetor 2019].

Gjithsej rreth 30 traktate u nënshkruan përpara shpërbërjes, të cilët do të qeverisnin marrëdhëniet e ardhshme midis dy shteteve. Të dy qeveritë ranë dakord për krijimin e bashkimit doganor, i cili lejonte shkëmbimet pa taksa të mallrave dhe shërbimeve, dhe lëvizjen e lirë të njerëzve. Ata gjithashtu miratuan politika tregtare dhe tarifa të përbashkëta, ranë dakord për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe nënshkruan traktate të tjerë që kishin të bënin me reformat tatimore, kufijtë e përbashkët, mbrojtjen dhe madje edhe me një bashkim monetar jetëshkurtër.

Gjithashtu nuk ekzistonin probleme me demarkacionin e kufijve pasi Çekosllovakia tashmë kishte qenë një federatë dhe kufijtë ishin vendosur qartë. Numri i marrëveshjeve dhe përgatitja e mirë e shpërbërjes në vetvete, vendosja e marrëdhënieve midis shteteve të veçuara në të ardhmen, sikurse shumë të afërta pavarësisht ndarjes, krijoi një bazë solide për marrëdhënie miqësore dhe pranimin e ndarjes nga të gjitha segmentet e shoqërisë.

Ajo çka është sidoqoftë më e rëndësishmja, forma e kësaj ndarjeje teknike u perceptua si e ligjshme dhe si një kompromis mes dy palëve, duke mos lënë hapësirë për ndonjë ankesë më të thellë dhe revizionizëm. Ndarja u pa gjithashtu si e dobishme për të dy shtetet. Sidomos në Sllovaki, ndarja nënkuptonte pavarësi të vërtetë për herë të parë në historinë e saj, duke i dhënë sllovaqëve një shans për të vendosur vetë për jetën e tyre. Nga ana çeke, ndarja u përballë me më shumë ndjenjë dhe nostalgji, si nga popullsia ashtu edhe nga elitat politike. Gjithsesi, për partinë qeverisëse dhe veçanërisht për Kryeministrin Klaus, ajo përfundimisht ishte e dobishme, duke i dhënë atij autonominë e nevojshme për zbatimin e një transformimi të shpejtë ekonomik, çka ishte qëllimi i tij personal, të cilit ai i dha rëndësi të madhe.

### **Respekt i ndërsjellë dhe ligjërimit publik konstruktiv**

Kur analizohet shpërbërja e Çekosllovakisë dhe faktorët të cilët kontribuan në paqen e saj, retorika dhe ligjërimiti i përhapur nga elitat politike në lidhje me ndarjen dhe pjesën tjetër të federatës nuk mund të anashkalohet. Gjatë negociatave midis Kryeministrave Klaus dhe Mečiar, si gjatë procesit të shpërbërjes ashtu edhe pas ndarjes, marrëdhëniet midis çekëve dhe sllovakëve mbetën të qeta dhe mjaft miqësore. Të dy Kryeministrat folën për njëri-tjetrin me respekt dhe as ata as pjesa tjetër e elitave politike në secilin shtet nuk u përpoq të mbillte përçarje apo të përhapte urrejtje midis çekëve dhe sllovakëve.

Kjo qasje shumë pragmatike dhe konstruktive nga elitat politike ndaj shpërbërjes, pa ndezur ndjenjat negative ndaj kombit tjetër në mesin e publikut të gjerë, ndikoi pozitivisht në situatën përgjithsisht pozitive të marrëdhënieve të ndërsjellta midis çekëve dhe sllovakëve, pavarësisht çështjeve dhe mosmarrëveshjeve të sipërpërmendura. Ligjërimiti i përgjegjshëm dhe konstruktiv i krijuar nga politikanët është diçka e dukshme dhe e rrallë kur krahasohet veçanërisht me situatën në ish-Jugosllavi apo edhe në Ballkanin Perëndimor në ditët e sotme. Në vend që të ndiznin ndjenjat dhe ankesat e mundshme nacionaliste (prezente sidomos midis sllovaqëve) apo ndjenjat e tradhtisë nga partneri i

tyre i federatës, të pranishme në një farë mase midis çekëve, drejtuesit e Çekosllovakisë zgjodhën alternativën tjetër.

### **Konkluzione dhe mësim për Ballkanin Perëndimor**

Disa përfundime mund të nxirren nga studimi i çështjes së shpërbërjes së Çekosllovakisë. Së pari, procesi i shpërbërjes tregoi se nëse një shtet mbijeton si një entitet apo shpërbëhet varet kryesisht nga elitat politike dhe jo nga masat. Dikush mund të evidentojë vendime specifike të marra nga elitat politike që nxisin në mënyrë të pakthyeshme procesin e shpërbërjes. Njëri prej tyre ishte lënia jashtë e publikut dhe heqja dorë nga referendumit. Roli i elitave politike dhe ndikimi i tyre tek publiku i gjerë, përmes ligjërimit që ata krijojnë, është gjithashtu i rëndësishëm, pasi ato mund të lehtësojnë potencialin ekzistues për tensione ndëretnike ose, nga ana tjetër, t'a përmirësojnë edhe më tej atë dhe t'a shfrytëzojnë për përfitimet e tyre. Jo vetëm në periudhën kohore që çoi në shpërbërjen e Çekosllovakisë apo gjatë shpërbërjes, por edhe zhvillimet e marrëdhënieve reciproke më vonë treguan se përkundër pjesës së konsiderueshme të historisë së përbashkët dhe afërsisë gjeografike, historike, kulturore dhe ideologjike, marrëdhëniet midis Republikës Çeke dhe Sllovakisë kanë qenë të varura në mënyrë të konsiderueshme nga udhëheqja politike në atë kohë. Ndërsa nën qeverinë e udhëhequr nga Klaus në vitet 1990 pati një tendencë të fortë për t'u shkëputur jo vetëm nga Sllovakia por edhe pjesa tjetër e vendeve të Vishegradit dhe për të qënë udhëheqës në procesin e integritit euro-atlantik. Nga ana tjetër, qeveria e udhëhequr nga Miloš Zeman, i cili u bë Kryeministër në 1998, tregoi shumë më shumë solidaritet për Sllovinë dhe mbështetja nga Republika Çeke, si dhe bashkëpunimi i ripërtërirë i Vishegradit, kontribuan që Sllovakia të ishte në gjendje të arrinte partnerët dhe t'i bashkoheshin BE-së së bashku në 2004.

Mësimi i dytë që duhet marrë në konsideratë është rëndësia e lartë e rolit të institucioneve politike kur trajtohet çështja e shpërbërjes së mundshme të një shteti përgjatë linjave etnike. Kjo është për shkak se këto mund të përkeqësojnë ose të përmirësojnë çështjen, në varësi të cilësisë së tyre. Institucionet demokratike të mirë-ndërtuara kanë potencialin të ofrojnë mjetet më të mira për të parandaluar tensionet etnike. Në dallim nga regjimet jodemokratike të dominuara nga një grup etnik, demokracia dhe funksionimi i fuqishëm i institucioneve demokratike, kur instaurohen duke patur parasysh ndarjet ekzistuese etnike dhe domosdoshmërinë e tejkalimit të tyre, mund t'i ofrojnë çdo grupi etnik përfaqësimin e duhur, përfshirje të përshtatshme në vendimmarrje dhe ndjesinë e një statusi të barabartë me grupet e tjera. Kur të gjitha grupet etnike mendojnë se pjesëmarrja e tyre në një proces demokratik është e rëndësishme dhe se ata kanë zë në çështjet e rëndësishme për ta, bazat për ndjenja pakënaqësie ndaj grupeve të tjera etnike zvogëlohen. Kjo mund të bëhet duke ndërtuar institucione demokratike të forta, të paanshme dhe të drejta, të cilat mbështesin përfshirjen dhe bashkëpunimin real në vend të përçarjeve dhe ndasive.

Nga ana tjetër, kur institucionet nuk janë aq të mirë-ndërtuara apo janë të dobëta, ato lehtësisht lejojnë që tensionet etnike të rriten. Në të njëjtën kohë, 'federata me të meta' e ndërtuar nga viti 1968 tregoi se, ndonëse centralizimi i tepërt nuk është i dëshirueshëm nga federatat demokratike, një model federal me ndarje të paqartë të pushteteve dhe qeveri republikane të forta nuk është i realizueshëm, veçanërisht për një shtet të ri demokratik.

Në drejtim të vendosjes së marrëdhënieve të mira reciproke dhe zbutjes së tensioneve nacionaliste, kanë një rëndësi thelbësore elitat politike e të dy entiteteve dhe qasja e tyre ndaj njëri-tjetrit, si dhe ligjërimi publik që ata krijojnë. Kur politikanët nga të dy palët flasin për njëri-tjetrin dhe kombin tjetër me të paktën respekt dhe mirëkuptim themelor, ai ka një efekt lehtësues mbi potencialin ekzistues për tensione ndëretnike. Edhe në rastin e Çekosllovakisë, ankesat e ndërsjellta mund të ishin shfrytëzuar lehtësisht nga politikanët oportunistë (dhe deri në një farë mase ato u shfrytëzuan nga Mečiar me konceptin e sovranitetit sllovak përpara zgjedhjeve të 1992), duke nxitur tensionet ndëretnike. Në këto situata, sidoqoftë, është e nevojshme udhëheqja politike e përgjegjshme që ndjek zgjidhje paqësore dhe të pranueshme nga të dy palët dhe një dialog konstruktiv të vazhdueshëm. Ky është një mësim shumë i rëndësishëm posaçërisht për Ballkanin Perëndimor ku deri më tani shumica e liderëve politikë veprojnë më tepër në një mënyrë të papërgjegjshme, duke përdorur pakënaqësinë ekzistuese në shoqëri për përfitimet e tyre politike, në vend që të tregojnë përpjekje reale për të tejkaluar tensionet dhe përçarjet ekzistuese.

Nga rasti i Çekosllovakisë, pavarësisht rrethanave të saja specifike, mund të nxirret përfundimi se komunikimi i hapur, i shpeshtë dhe me respekt, ndërthurur me një udhëheqje politike të përgjegjshme që ka në zemër interesat më të mira afatgjata të vendit të vet, në vend të fitoreve politike afatshkurtra, krijon kushte të mira për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe tensioneve të ndërsjellta. Kjo vlen jo vetëm për federatat që funksionojnë keq, por edhe për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe bashkëpunimin e tyre rajonal të ndërsjelltë. Në rastin e mosmarrëveshjeve dypalëshe ekzistuese, një zgjidhje e qëndrueshme, e pranuar reciprocisht, duhet të ndiqet përmes një komunikimi të hapur, intensiv dhe respektues midis të dy palëve, në vend të përfitimeve politike afatshkurtra.

# Pajtimi sllovako-hungarez dhe mësimet për Ballkanin Perëndimor

*Nikolett Garai, Tomáš Strážay*

## Hyrje

Marrëdhëniet sllovako-hungareze kanë qenë vazhdimisht më të ndjeshmet në grupin e V4. Marrëdhënia midis Sllovakisë dhe Hungarisë ishte problematike që prej viteve 1990, pavarësisht se rënia e regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe perspektivat e integritimit në strukturat euro-atlantike premtuan mundësinë e një epoke të re pajtimi. U bë e qartë se vetëm anëtarësimi në platforma shumëpalëshe - si BE-ja apo V4 - nuk mund të ishte kura për zgjidhjen e të gjitha çështjeve problematike midis Sllovakisë dhe Hungarisë, pasi tensionet vazhduan të përkeqësoheshin edhe pas pranimit në BE, ndërsa bashkëpunimi mes V4 qëllimisht i shmangi çështjet e ndjeshme dypalëshe.

Zgjedhjet parlamentare në Hungari dhe Sllovaki në 2010 ndryshuan situatën politike dhe klimën e përgjithshme në të dy vendet. Gjithsesi, mund të argumentohet se përmirësimi i marrëdhënieve dypalëshe bazohet më shumë në retorikën e ndryshuar dhe stilin e komunikimit, sesa në një proces të vërtetë pajtimi. Vullneti politik shtesë dhe mirëmbajtja e një qasjeje konsensuale mbeten parakushtet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve ekzistuese dhe çmontimin e stereotipeve etnike të rrënjosura thellë, të cilat rrjedhin nga narrativat historike të ndryshme dhe selektive, nga memoria kolektive dhe nga ndryshimi i status quo-së.

Në pjesën e parë, punimi ofron një përmbledhje të shkurtër të çështjeve më problematike në marrëdhëniet dypalëshe sllovako-hungareze në kontekstin e tridhjetë viteve të fundit. Së dyti, vlerësohen disa nisma qeveritare dhe përpjekjet joqeveritare për pajtim. Së fundmi, punimi synon të përmbledhë parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin e marrëdhënieve sllovako-hungareze në të ardhmen dhe ofron disa mësimet të nxjerra, si dhe rekomandime për vendet e Ballkanit Perëndimor.

## **Një përmbledhje e shkurtër e marrëdhënieve dypalëshe sllovako-hungareze**

Përveç paragjyqimeve dhe stereotipeve të rrënjosura thellë, të cilat rezultojnë nga bashkëjetesa më shumë se një mijë vjeçare e hungarezëve dhe sllovakëve në një shtet, shumica e tensioneve në marrëdhëniet dypalëshe lidhen me statusin e pakicës hungareze që jeton në Sllovaki. Pas ndarjes së Çekosllovakisë në 1993, Sllovakia u bë vendi i vetëm në Evropën Qendrore me një numër të konsiderueshëm të pakicave etnike. Pakica hungareze nuk është vetëm pakica më e madhe që jeton në territorin e Sllovakisë, që përfaqëson rreth 8,5% të popullsisë së përgjithshme sipas censusit të vitit 2011<sup>31</sup>, por e

<sup>31</sup> Statistical Office of the Slovak Republic, "Population by nationality - 2011, 2001, 1991",

vetmja që ka përfaqësim politik përkatës në parlament, dhe, herë pas here, gjithashtu edhe në aparatit shtetëror.<sup>32</sup> Statusi i pakicës hungareze dhe besnikëria e saj ndaj shtetit sllovak u konsiderua përgjatë transformimit si një nga çështjet më të ndërlikuara politike në Sllovaki. Për shkak të narrativave nacionaliste kontradiktore, që ekzistojnë edhe sot në shoqëritë sllovaqe dhe hungareze, përpjekjet për të ruajtur dhe ndërtuar marrëdhënie midis hungarezëve etnikë dhe shtetit amë u panë me dyshim nga qarqet politike. Këto narrativa ende kanë një ndikim të madh në identitetin kolektiv të të dy palëve, duke e bërë të vështirë tejkalimin e frikës dhe anktheve.

Nga ana tjetër, statusi i pakicave hungareze që jetojnë jashtë, veçanërisht në vendet fqinje, ka qenë në Hungari një nga çështjet më të rëndësishme politike; gjithashtu edhe për faktin se mbështetja për pakicat hungareze jashtë vendit është përfshirë drejtpërdrejt në kushtetutën hungareze, ndërsa mbrojtja e interesave të pakicave hungareze, si një element i politikës rajonale, ka mbetur një nga prioritetet e politikës së jashtme hungareze që prej zgjedhjes së qeverisë së parë në mënyrë demokratike, pas ndryshimit të regjimit.

Pas ndarjes së Çekosllovakisë, marrëdhëniet midis shumicës sllovaqe dhe pakicës hungareze duhet të pasqyrojnë situatën e re gjeopolitike. Në fillim lulëzuan takimet në nivelin më të lartë politik dhe ka pasur 30 takime të presidentëve, kryeministrave, ministrave dhe sekretarive shtetërore midis janarit 1993 dhe maj 1994.<sup>33</sup> Gjithsesi, pas entuziazmit fillestar, kompleksiteti i çështjeve problematike dhe mungesa e interesit nga të dy palët pezulluan përpjekjet e pajtimit. Qeveria e atëhershme e Kryeministrit Mečiar zgjodhi modelin e një shteti etnocentrik që vendos një grup etnik/kombësi përpara një tjetri. Megjithatë Mečiar dhe bashkëpunëtorët e tij u mposhtën nga një koalicion demokratik, duke përfshirë edhe Strana maďarskej koalície/Magyar Koalíció Pártja, në 1998, edhe të dy qeveritë pasuese të udhëhequra nga Dzurinda nuk ishin gjithmonë të lira nga tensionet etnike. Pjesëmarrja e Partisë Kombëtare Sllovaqe (Slovenská národná strana – SNS), haptasi nacionaliste dhe anti-hungareze, në qeverinë e parë të Fico-s (2006-2010) dhe legjitimimi i programit të saj nga partnerët e koalicionit u konsiderua si një hap prapa nga përfaqësuesit e pakicës hungareze, si dhe nga qeveria hungareze. Çështja e ndryshimit të Ligjit për Gjuhën Zyrtare nga viti 2009 u vlerësua si një simboli i “majës së ajsbergut” nga kritikët e qeverisë së Robert Fico-s në Hungari, sikurse edhe në Sllovaki. Për më tepër, marrëdhëniet dypalëshe midis Sllovakisë dhe Hungarisë u helmuan nga disa përfaqësues të koalicionit qeverisës që shprehën hapur deklarata anti-hungareze.

Elitat qeverisëse hungareze gjithashtu kanë kontribuar në përkeqësimin e marrëdhënieve dypalëshe me Sllovaquinë; mungesa e empatisë politike dhe mbështetja për veprim të

---

[https://slovak.statistics.sk/wps/wcm/connect/bd447dc5-c417-48d6-89e1-0a2d60053cf6/Table\\_10\\_Population\\_by\\_nationality\\_2011\\_2001\\_1991.pdf?MOD=AJPERES&CVID=kojGfKx&CVID=kojGfKx&CVID=kojGfKx](https://slovak.statistics.sk/wps/wcm/connect/bd447dc5-c417-48d6-89e1-0a2d60053cf6/Table_10_Population_by_nationality_2011_2001_1991.pdf?MOD=AJPERES&CVID=kojGfKx&CVID=kojGfKx&CVID=kojGfKx), [2 Nëntor 2019].

<sup>32</sup> Në të shkuarën, Partia e Koalicionit Hungarez – Strana maďarskej koalície/Magyar Koalíció Pártja, kishte përfaqësuar interesat e pakicës hungareze. Pas zgjedhjeve parlamentare të 2010, gjithsesi, SMK (e riemëruara Partia e Komunitetit Hungarez/Magyar Közösség Pártja) nuk arriti të hynte në parlament. Shumica e votave nga votuesit hungarez shkuan për partinë Most-Híd, e cila e deklaroi veten si partia e parë që theu hendekun midis sllovakëve dhe hungarezëve.

<sup>33</sup> Boros F., *A magyar-szlovák kérdés történeti kontextusban*, Hantken, Budapest, 2011.

njëanshëm mund të konsiderohen si një nga gabimet më thelbësore nga ana e Hungarisë. Ishte qeveria e parë e Orbánit që vendosi lidhje institucionale me pakicat hungareze në vendet fqinje. Promovimi i Konferencës së Përhershme Hungareze në 1999, që supozohej t'u ofronte përfaqësuesve të pakicave hungareze në vendet fqinje një mundësi të drejtpërdrejtë për konsultime me institucionet e shtetit hungarez, u pa me dyshime nga pala sllovaqe. Miratimi i Ligjit për Statusin Hungarez u konsiderua si një tjetër përpjekje për t'i afruar hungarezët me shtetin e tyre amë dhe për këtë arsye u refuzua nga Sllovakia. Themelimi i Forumit të Deputetëve të Basenit të Karpateve nga Parlamenti hungarez, i cili i dha parlamentit hungarez një instrument të drejtpërdrejtë komunikimi me deputetë e parlamenteve të tjerë kombëtarë, u kundërshtua kategorikisht nga Sllovakia - argumenti ishte që Hungaria nuk duhet të ndërtojë lidhje institucionale me deputetë të zgjedhur në vende të tjera. Megjithëse përpjekja e parë për të iniciuar një ligj për shtetësisë e dyfishtë në 2004 nuk ishte e suksesshme, qeveria e re e udhëhequr nga FIDESZ shfrytëzoi rastin dhe miratoi ligjin vetëm disa javë pas zgjedhjeve të majit 2010 - duke e bërë këtë pa u këshilluar me qeveritë e vendeve fqinje. Qeveria sllovaqe reagoi me modifikimin e ligjit për nënshtetësinë, i cili në fakt i heq nënshtetësinë sllovaqe një personi që ka nënshtetësinë e një vendi tjetër.

Disa çështje të tjera nga e kaluara më e largët midis Hungarisë dhe Sllovakisë gjithashtu mbeten të pazgjidhura - çështja Gabčíkovo-Nagyymaros, e cila daton në 1977, është një shembull i njohur. Megjithëse ky termocentral i përbashkët hidroenergjetik mbi Danub ishte menduar të bëhej një shembull i marrëdhënieve të mira dypalëshe midis (së atëhershmes) Çekosllovakia dhe Hungarisë, ai u shndërrua në një nga çështjet më përçarëse. Megjithëse Gjykata Ndërkombëtare ka marrë një vendim mbi çështjen vite më parë dhe e gjithë çështja iu kalua ekspertëve përkatës, aktvendimi i Gjykatës ende nuk është zbatuar.

Ndryshimi në stilin e komunikimit midis Sllovakisë dhe Hungarisë u shfaq me qeverinë e udhëhequr nga Kryeministri Radičová në 2010. Megjithëse qeveria mbijetoi vetëm dy vjet, qeveria e dytë dhe e tretë që pasoi nga Fico vazhdoi një politikë të ngjashme ndaj pakicave kombëtare. Në vitet 2010-2012 dhe përsëri pas vitit 2016, njëra nga partitë që përfaqëson komunitetin hungarez - Most-Híd - ka qenë pjesë integrale e koalicionit qeveritar.

Disa arritje në lidhje me statusin e komunitetit hungarez në Sllovaki janë shënuar pas vitit 2016. Mbi të gjitha, është hartuar dhe miratuar një ligj për financimin e kulturave të pakicave. Presidenti i sapozgjedhur Zuzana Čaputová duket se do të vazhdojë politikën respektuese ndaj pakicave, pasi ajo - si presidenti i parë sllovak - ftoi dy përfaqësues të komunitetit hungarez në ekipin e saj të këshilltarëve ekspertë të jashtëm. Një gjest simbolik ndaj pakicës hungareze ishte edhe pjesëmarrja e saj në Universitetin Veror në Gombaszög, në të cilin nuk kishin marrë pjesë krerët e mëparshëm të shtetit pavarësisht ftesës së organizatorëve.

Rritja e shkëmbimeve tregtare midis Sllovakisë dhe Hungarisë gjithashtu kanë forcuar frymën e bashkëpunimit. Për Hungarinë, Sllovakia është partneri i tretë më i rëndësishëm tregtar, ndërsa për Sllovaquinë, Hungaria renditet e katërta në listën e partnerëve tregtarë.



## **Përprojekjet për pajtim**

Në këtë pjesë, do të përshkruhen nisma thelbësore të përzgjedhura - qeveritare dhe joqeveritare - që kontribuojnë në pajtimin midis Sllovakisë dhe Hungarisë.

**Traktati midis Republikës Sllovaqe dhe Republikës së Hungarisë** për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin miqësor u nënshkrua në Paris në mars 1995, dhe si i tillë ishte pjesë e një iniciative më të gjerë të Paktit të Stabilitetit. Me nënshkrimin e Traktatit, si Sllovakia dhe Hungaria deklaruan dëshirën e tyre për t'u integruar në strukturat euro-atlantike, ndërsa marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë u konsideruan si një nga parakushtet më të rëndësishme për integrimin e tyre në BE dhe NATO. Traktati ishte dokumenti i parë i rëndësishëm dypalësh në historinë e re të marrëdhënieve sllovakohungareze dhe mbetet dokumenti më i ndërlikuar midis Sllovakisë dhe Hungarisë deri më sot. Çështjet më problematike që lidhen me Traktatin nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij, por me zbatimin. Kjo vlen edhe për Komisionet e Përzjera Dypalëshe, të krijuara si instrumente të domosdoshme për zbatimin e paragrafëve të veçantë të Traktatit.<sup>34</sup> Instrumenti i këtyre komisioneve nuk është shfrytëzuar sa duhet dhe disa komisione nuk kanë përmbushur pritjet që lidhen me rregullsinë e takimeve të tyre dhe rezultatet e arritura.

**Përfshirja e përfaqësuesve të komunitetit hungarez në qeverinë e vendit** mund të krijojë një bazë të mirë për bashkëpunimin e ardhshëm midis partive politike sllovaqe dhe hungareze. Nga ana tjetër, përvoja e viteve 1998-2006 tregon se vetëm pjesëmarrja e përfaqësuesve të komunitetit hungarez nuk është e mjaftueshme për të zgjidhur të gjitha problemet dhe për të kapërcyer të gjitha boshllëqet midis dy kombeve, si dhe hapa të tjerë nevojitet të ndërmerren për të kontribuar në përmirësimin e dialogut ndëretnik.

Lista e nismave qeveritare dhe joqeveritare që çojnë në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe do të përfshinte disa projekte, disa prej të cilëve janë të listuara më poshtë. Fatkeqësisht, ato nuk janë zbatuar plotësisht ose, megjithë vlerën e tyre të madhe simbolike, thjeshtë janë harruar ose lënë pas dore.

### Sesione të Përbashkëta të Komisioneve të Parlamenteve Kombëtare

Një nga pasojat e rritjes së tensioneve në marrëdhëniet dypalëshe gjatë qeverisë së parë Fico ishte një iniciativë e krerëve të parlamenteve kombëtarë. Në dhjetor 2008 ata iniciuan takime të përbashkëta të komisioneve të parlamenteve kombëtare, si një instrument tjetër për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe. Përmes këtyre takimeve, deputetët e Këshillit Kombëtar të Republikës Sllovaqe dhe të Asamblesë Kombëtare Hungareze

---

<sup>34</sup> Komisionet e Përzjera fokusohen në këto fusha: 1. Integrimi evropian dhe euro-atlantik, 2. Ushtria dhe çështje të tjera të sigurisë, 3. Bashkëpunimi ekonomik, 4. Mbrojtja e mjedisit, 5. Transporti dhe infrastruktura, 6. Çështje të kulturës dhe medias së shkruar, 7. Shëndeti, sigurimi shëndetsor dhe kujdesi social, 8. Punët e brendshme, 9. Arsimi, shkenca, sportet dhe rinia, 10. Bashkëpunimi ndërkufitar, 11. Bujqësia, veterinaria dhe kujdesi fitosanitar, 12. Pakicat kombëtare.

supozohej të diskutonin dhe mundësisht të gjenin zgjidhje për disa nga problemet në marrëdhëniet dypalëshe.

### E Kaluara e Përbashkët, e Ardhmja e Përbashkët në Pasqyrën e Projekteve të Përbashkëta

Më 14 qershor 2007 Kryeministrat Robert Fico dhe Ferenc Gyurcsány ranë dakord për një dokument të titulluar *E kaluara e përbashkët, e ardhmja e përbashkët në Pasqyrën e Projekteve të Përbashkëta*<sup>35</sup>. Dokumenti përfshinte katërmbëdhjetë pika dhe pasqyronte forma të ndryshme të bashkëpunimit, përfshirë bashkëpunimin ekonomik dhe kulturor. Kryeministrat deklaruan se të katërmbëdhjetë pikat përfaqësonin projekte të arritshme në të ardhmen e parashikueshme.

Ndonëse lista e projekteve prioritare të dokumentit *E Kaluara e Përbashkët, e Ardhmja e Përbashkët* përmban vetëm çështje jo-konfliktuale, ka pasur një vonesë të konsiderueshme në zbatimin e tyre. Prandaj, Kryeministrat u takuan sërish në shtator 2009 dhe publikuan një deklaratë të përbashkët, e cila u përmblodh në thelb në 11 pika<sup>36</sup>. Në njërin nga pikat, Kryeministrat përsëri theksuan nevojën për t'u rivendosur mbledhjet e të gjitha Komisioneve të Përziera për zbatimin e Traktatit të 1995. Kryeministrat gjithashtu i besuan Ministrave të Punëve të Jashtme përgatitjen e një pakete të zgjeruar bashkëpunimi për t'u shqyrtuar nga krerët e qeverive, të cilët do të propozonin krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Hungaro-Slovak, si një organ konsultativ jo-politik i pavarur për nxitjen e bashkëpunimit midis dy vendeve. Një tjetër rol i Këshillit do të ishte mbikëqyrja e Fondit të planifikuar të Bashkëpunimit Hungaro-Slovak, i cili kishte për qëllim mbështetjen e projekteve, bursave dhe programeve të shkëmbimit të studentëve, si dhe aktivitete kulturore, arti dhe sportive që fokusohen tek promovimi i bashkëjetesës dhe bashkëpunimit hungaro-slovak.

Mund të argumentohet se shumica e detyrave të përfshira në dy dokumentet e lartpërmendura, përfshirë themelimin e Këshillit të Bashkëpunimit Hungaro-Slovak dhe Fondit të Bashkëpunimit, nuk është përmbushur ende.

### Çmimi për fqinjësi të mirë dhe mirëkuptim

Një tjetër nismë simbolike që mbështet standardizimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe është krijimi i një tradite të re të çmimit të titulluar "Fqinjësi të mirë dhe mirëkuptim", për një individ ose komunitet në secilin shtet, për të nderuar kontributet e tyre të shkëlqyera në bashkëpunimin sllovak-hungarez. Një çmim i tillë u inicua nga ish

---

<sup>35</sup> Úrad vlády Slovenskej republiky, "Informácia o priebehu a výsledkoch pracovného stretnutia predsedov vlád SR a MR v Bratislave dňa 18.6.2007", [www.rokovania.sk/File.aspx/ViewDocumentHtml/Mater-Dokum-66229?prefixFile=m\\_](http://www.rokovania.sk/File.aspx/ViewDocumentHtml/Mater-Dokum-66229?prefixFile=m_), [3 Nëntor 2019].

<sup>36</sup> Úrad vlády Slovenskej republiky, "Meeting between Gordon Bajnai, Hungarian prime Minister, and Robert Fico, Slovak Prime Minister in Szécsény, Hungary", <http://www.sfm.vlada.gov.sk/17200/spolocne-stanovisko-roberta-fica-a-gordona-bajnaia.php>, [3 Nëntor 2019].

ministrat e jashtëm Ján Kubiš dhe Kinga Göncz në 2008 dhe është dhënë çdo vit deri në 2013.

### Nisma për Pajtim e Ipeshkve Katolikë

Procesi i pajtimit midis Kishës Katolike sllovae dhe hungareze filloi në mënyrë simbolike në qytetin Esztergom-it në vitin 2006. Gjatë takimit të tyre dhe mbajtjes së përbashkët të meshës peshkopët sllovakë dhe hungarezë publikuan letra zyrtare në të cilat kërkuan ndjesë për veprat e tyre në të kaluarën dhe kërkuan për falje. Megjithëse mesha u ndoq nga shumë adhurues nga të dy vendet, nisma nuk u pasua nga asnjë deklaratë politike dhe u pasqyrua dobët në median kombëtare. Peshkopët ndërmorën nismën edhe një herë në 2008, kur ata bënë thirrje publikisht për mirëkuptim midis dy kombeve dhe hodhën poshtë çdo formë dhune dhe ekstremizmi.

### Tryeza e Rrumbullakët e Hungarezëve në Sllovaki

Krijimi i Tryezës së Rrumbullakët u iniciua nga Rrjeti i Informacionit Qytetar i Sllovakisë Jugore në Konferencën e Forumit Qytetar në 2008, e mbajtur në Šamorín/Somorja. Tryeza e Rrumbullakët është një institucion i hapur, i pavarur, jo-partizan, vullnetar dhe informal, që funksionon si një platformë ombrellë për organizatat dhe personalitetet e nderuara të komunitetit hungarez në Sllovaki. Çdo organizatë (apo institucion) kulturor, i vetëqeverisur, shtetëror apo joqeveritar mund të marrë pjesë në takimet kombëtare të Tryezës së Rrumbullakët, e cila, midis kriterëve të tjera formale, duhet të veprojë në interes të komunitetit hungarez në Sllovaki, të nxisë kulturën, arsimin dhe identitetin e pakicave, dhe duhet të jetë e gatshme të ndajë përgjegjësinë për zhvillimin e komunitetit dhe të mbështesë advokimin e tij.

### Instituti "Forumi i Kërkimeve të Pakicave"

Instituti "Forumi i Kërkimeve të Pakicave" u themelua në vitin 1996. Aktualisht, Instituti ndodhet në Šamorín/Somorja, në Sllovakinë e Jugut. Qëllimi i tij kryesor është të kryejë studime komplekse mbi situatën dhe kulturën e pakicave kombëtare në Sllovaki, si dhe të dokumentojë trashëgiminë e tyre të shkruar dhe madje edhe më të gjerë. Si një organizatë jofitimprurëse, Instituti funksionon si një institucion publik dhe shërbimesh. Instituti mikpret një qendër burimore me Bibliotekën Hungareze (Bibliotheca Hungarica), Arkivat Hungarezë të Sllovakisë dhe Qendrën për Dixhitalizim dhe Bazat e të Dhënave të Internetit. Instituti ndërmerr hulumtime të ndryshme të politikave, boton libra dhe revista, organizon seminare të ndryshme, kurse trajnimi dhe konferenca për tema të ndryshme.<sup>37</sup>

---

<sup>37</sup> Instituti "Forumi i Kërkimeve të Pakicave", [www.foruminst.sk](http://www.foruminst.sk)

## Forumi European Sllovako-Hungarez dhe Forumi i Diskutimit Sllovako-Hungarez

Qëllimi kryesor i projektit të koordinuar nga Shoqata e Politikës së Jashtme Sllovake në bashkëpunim me Institutin Hungarez të Çështjeve Ndërkombëtare, në vitet 2007-2012, ishte të kontribuonte në identifikimin e interesave të përbashkëta të Sllovakisë dhe Hungarisë dhe zbatimin e tyre në nivel evropian, rajonal, si dhe dypalësh. Një nga qëllimet ishte të kontribuonte në demitizimin dhe ndryshimin cilësor në marrëdhëniet dypalëshe midis Sllovakisë dhe Hungarisë, duke zhvilluar një dialog të rregullt dhe të strukturuar të ekspertëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi.

Në 2013, iniciativa u rimërua Forumi i Diskutimit Sllovako-Hungarez dhe fitoi mbështetjen financiare nga skema e granteve të Ministrisë së Jashtme dhe të Çështjeve Europiane Sllovake. Seanca e parë e Forumit për Diskutim Sllovako-Hungarez u mbajt në vitin 2013, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të dy ministrive të punëve të jashtme dhe të think tankeve, e ndjekur nga dy takime të tjera në 2014 dhe 2015. Aktualisht projekti është në pritje pasi asnjë palët e interesuara të përfshira ndjejnë një nevojë urgjente për të organizuar një seancë të përbashkët.

## Teksti Mësimor i Historisë së Përbashkët

Një iniciativë e rëndësishme e lidhur me punën e Komisionit të Historianëve Sllovako-Hungarez është hartimi i një libri të historisë së përbashkët, i cili supozohet të përshkruaj në mënyrë kronologjike 15 periudha historike. Qëllimi i një teksti të tillë nuk është të zëvendësojë librat shkollorë të historisë, por të shërbejë si një burim informacioni shtesë për studentët dhe mësuesit në faza të ndryshme të procesit arsimor. Secili nga pesëmbëdhjetë kapitujt supozohet të hartohet nga një historian sllovak dhe një historian hungarez, ndërsa të dy autorët gjithashtu pritet të bien dakord për një përmbledhje të përbashkët. Sidoqoftë, projekti ende nuk është implementuar me sukses. Sponsorizuesit institucional dhe ekspertët kryesorë të projektit janë Akademitë e Shkencave Sllovake dhe Hungareze.

Ekzistojnë disa nisma të tjera të mira kulturore joqeveritare si bashkëpunimi midis Shoqatës së Shkrimtarëve Hungarez dhe homologes së saj në Sllovaki. Në vitin 2019, ato ranë dakord për përkthimin e ndërsjellë dhe të rregullt të letërsisë bashkëkohore sllovake dhe hungareze në formën e revistave, antologjive dhe vëllimeve individuale.

## **Gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra**

Në të kaluarën pajtimi sllovako-hungarez është perceptuar shpesh si një akt i vetëm që mund të arrihet me një deklaratë politike ose marrëveshje. Duhet të nënvizohet se pajtimi është një proces i gjatë në kohë dhe, në disa aspekte, mund të duhen disa vjet për të arritur rezultatet e para të kënaqshme dhe përfundimtare. Prandaj, mbështetja adekuate

dhe e vazhdueshme nga përfaqësuesit e të dy shteteve, duke tejkalluar retorikën politike, është një parakusht i domosdoshëm.

Përvoja e (pothuajse) tridhjetë viteve të fundit tregon se në nivel politik, veprimet e njëanshme mbizotëruan mbi nismat e përbashkëta. Edhe pse këto të fundit u paraqitën në deklarata politike, shumica e tyre nuk janë zbatuar.

Përkundër të gjitha nismave, programeve dhe projekteve, asnjë nga qeveritë, as aktorët joqeveritarë nuk kanë patur sukses në zbatimin e një procesi pajtimi midis Sllovakisë dhe Hungarisë. Ndaj mund të konkludohet se procesi i pajtimit kërkon një qasje të re si nga ana qeveritare ashtu edhe nga ajo joqeveritare. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rolit dhe mundësive të brezave të ardhshëm të të rinjve, të cilët mund të jenë pararojë e proceseve të pajtimit.

Zhvillimet e së kaluarës treguan se as qeveritë e krahut të majtë as të krahut të djathtë nuk e mbështetën procesin e pajtimit midis Sllovakisë dhe Hungarisë në mënyrë bindëse. Mund të argumentohet se përkatësia etnike rezultoi të jetë një faktor më i rëndësishëm sesa afërsia apo dallimet ideologjike.

Traktati i 1995 mund të konsiderohet një kornizë e përshtatshme legislative për zhvillimin e marrëdhënieve sllovak-hungareze; sidoqoftë, të gjithë paragrafët e tij duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike. Krijimi i komiteteve të përbashkëta ndërqeveritare mund të jetë një praktikë e mirë për të nxitur bashkëpunimin, megjithatë, nëse vetëm vendimet ndiqen nga zbatimi i duhur.

Përmirësimi i dialogut civil dhe intensifikimi i bashkëpunimit midis organizatave të ndryshme joqeveritare mbetet një nga parakushtet për zhvillimin e marrëdhënieve sllovak-hungareze. Aktualisht, disa nga nismat e udhëhequra nga OJQ-të hasin mungesë të vazhdimësisë, ndërsa të tjera kanë mbivendosje të aktiviteteve. Një tjetër detyrë e rëndësishme është krijimi i një këshilli dhe fondi të pavarur bashkëpunimi sllovak-hungarez që do të mbështesë projektet që synojnë përmirësimin e dialogut dypalësh.

Për shkak të kushteve të ndryshme historike dhe strukturore, shembuj të huaj të pajtimit, siç është pajtimi franko-gjerman ose polako-gjerman, janë të zbatueshëm vetëm pjesërisht. Një grup studimi i përbërë nga ekspertë lokalë mund të themelohet për të vlerësuar mundësitë e një transferimi të njohurive dhe përvojës.

Pavarësisht problemeve dhe tensioneve të mbetura, marrëdhëniet sllovak-hungareze paraqesin gjithashtu shumë shembuj të mirë, qoftë në nivel bashkëpunimi dypalësh apo rajonal. Ajo që nevojitet gjithashtu në procesin e pajtimit është një fokus më i madh në shembuj pozitivë në marrëdhëniet reciproke; tejkalimi i ndasive mund të forcojë bashkëpunimin në zonat ekzistuese dhe të krijojë hapësirë për iniciativa të reja - si në nivelin qeveritar ashtu edhe në ato të OJQ-ve.

## **Rekomandime për vendet e Ballkanit Perëndimor**

Në pikëpamjen e mësipërme, parashtrohen rekomandimet e mëposhtme:

- Të intensifikohet dialogu politik zyrtar në të gjitha nivelet dhe të shmangen veprimet e njëanshme, përveçse nëse këto janë konsultuar me partnerët e vendit partner; të shmangët miratimit i legjislacionit që ndërhyt në sistemet ligjore të vendeve fqinje pa u konsultuar me to.
- Të krijohet dhe përditësohet rregullisht lista e prioriteteve të bashkëpunimit dhe të zbatohen pa vonesë.
- Të konsiderohet se si të rinjtë mund të përfshihen nga të dy palët në aktivitete pajtimi.
- Të shmangët ideja e anëtarësimit në BE si zgjidhje për mosmarrëveshjet dhe problemet dypalëshe.
- Të konsiderohet përfshirja e ekspertëve të pavarur, palë të treta, në konsultime në rast të tejzgjatjes së problemeve dhe çështjeve të pazgjidhura.
- Të mbështeten aktivitetet e shoqërisë civile në të dy vendet përmes krijimit të këshillave dhe fondeve të bashkëpunimit dypalësh.
- Të mbështetet zhvillimi i iniciativave ndërkufitare dhe të krijohen kushtet e favorshme për zhvillimin e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe lokal.
- Të nxitet bashkëpunimi ekonomik në të gjitha nivelet.
- Të garantohen të drejtat e pakicave dhe të shmangët çdo tendencë diskriminuese me bazë etnike.
- Të krijohet një mjedis i favorshëm për edukimin multikulturor.
- Të shmangët mbivendosja e iniciativave dhe ndarja e burimeve.

# Tejkalimi i trashëgimisë të së kaluarës së bashku: Serbia dhe Hungaria

*Igor Novakovic, Anna Orosz*

## Hyrje

Hungaria dhe Serbia kanë një histori të përbashkët, e cila mund të karakterizohet si nga bashkëpunimi ashtu edhe nga konflikti. Në qendër të debateve më të fundit ka qenë territori i njohur që nga mesi i shekullit të 19<sup>-të</sup> si Vojvodina, e cila u shkëput nga Hungaria<sup>38</sup> pas Luftës së Parë Botërore si pasojë e Traktatit të Trianonit. Zona - e cila zakonisht gëzonte një status të veçantë qeveritar - ndër shekuj pësoi ndryshime të rëndësishme në përbërjen e popullatës qoftë për shkak të pushtimit osman apo për shkak të vendbanimeve të qëllimshme të popullsisë nga perandorët austriakë dhe udhëheqësit hungarezë.

Lufta e Dytë Botërore dhe vendimi në Trianon në 1920 patën një ndikim të madh në marrëdhëniet e serbëve dhe hungarezëve që jetojnë në atë zonë. Hungaria humbi 71 përqind të territorit dhe 59 përqind të popullsisë së saj. Kjo traumë kombëtare kontribuoi në përpjekje revizioniste në politikën e jashtme hungareze në periudhën e parë. Në të njëjtën kohë, Mbretëria e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve përfitoi territorin e Vojvodinës me një numër të konsiderueshëm të banorëve hungarezë (rreth 28% e popullsisë).

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Hungaria rimori kontrollin mbi Vojvodinën me mbështetjen e Gjermanisë naziste dhe në janar 1942 forcat e tyre ushtarake kryen një sulm kundër partizanëve që u shoqërua me vrasje masive të civilëve, kryesisht serbë dhe hebrenj. Ndërsa lufta mbaroi me rënien e fuqive të boshtit, Hungarisë iu desh përsëri të tërhiqej prapa kufijve të Trianonit. Më 1944-1945 forcat partizane dhe komuniste fituan kontrollin mbi territorin jugosllav dhe u hakmorën kundër armiqve të tyre të mëparshëm. Aksionet shkaktuan gjithashtu humbje masive të civilëve. Hungarezët (dhe gjermanët) u ekzekutuan duke u bazuar në ndëshkimin kolektiv.

Si pjesë e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, Vojvodina fitoi statusin e veçantë të krahinës autonome (Krahina Autonome e Vojvodinës, këtej e tutje KAV) me një gamë të gjerë të drejtash dhe autoriteti. Pas vdekjes së Titos, Slobodan Millosheviçi nxiti centralizimin dhe shkurtoi të drejtat dhe privilegjet e krahinës, ku gjithashtu u kufizuan pjesërisht të drejtat e komunitetit hungarez (për shembull në arsim). Luftërat në ish-Jugosllavi dhe nacionalizmi në rritje minuan terrenin e bashkëjetesës në paqe. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe "humbja" e Kosovës u shndërruan në një traumë e ngjashme me Trianonin për serbët dhe kontribuan në një dyshim të shtuar edhe kundër pakicës hungareze, një prej grupeve etnike më të organizuara në Serbi që jeton ngjitur me kufirin e atdheut të tyre. Fatkeqësisht, nacionalizmi në rritje midis serbëve gjithashtu çoi në disa

---

<sup>38</sup> Së bashku me territoret e tjera (Sllovakia, Rutenia, Transilvania, Banatet lindore, Kroazia dhe pjesë të Austrisë).

përplasje etnike me hungarezët, duke ngritur shqetësime për qeveritë hungareze. Qeveria e parë hungareze e zgjedhur lirisht përcaktoi mbrojtjen e pakicave hungareze, si një nga shtyllat kryesore të politikës së saj të jashtme, por ajo gjithashtu respektoi kufijtë e përcaktuar ndërkombëtarisht dhe përkundrazi mbështeti marrëdhëniet me komunitetet e pakicës hungareze nën ombrellën e procesit të integritit euro-atlantik.

Pas ndryshimit të regjimit në Serbi, zgjedhja e rrugës europiane si përparësi strategjike ishte një ndryshues kryesor në marrëdhëniet dypalëshe. Politika e jashtme hungareze e konsideron integritin euro-atlantik të Serbisë dhe më gjerë të rajonit të Ballkanit Perëndimor si garanci e paqes dhe sigurisë për rajonin dhe gjithashtu për Hungarinë. Për këtë arsye, Hungaria mbështet fuqimisht pranimin e Serbisë në strukturat euro-atlantike dhe ndërtimi i marrëdhënieve miqësore u bë një interes i përbashkët i të dy vendeve. Është interesante që të dy partitë e krahut të djathtë arritën të ndërtojnë marrëdhënie të forta ndërqeveritare dhe u ndërmorën nga të dy palët akte simbolike të nivelit të lartë për të njohur mizoritë e mëparshme. Që atëherë bashkëpunimi ndërqeveritar arriti nivelin më të lartë në histori, duke kontribuar edhe në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike. Sidoqoftë, bashkëpunimi i komunitetit hungarez me serbët duhet të zhvillohet më tej në mënyrë që të forcohet terreni shoqëror i pajtimit.

### **Praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra**

Procesi i pajtimit midis Serbisë dhe Hungarisë u mbështet kohët e fundit nga disa faktorë: a) periudha e konsiderueshme e kohës që ka kaluar nga konflikti i fundit; b) ekzistenca e pakicës hungareze/serbe në Serbi/Hungari dhe përmirësimi i kornizave për të drejtat e pakicave; c) procesi i integritit në BE; dhe d) marrëdhëniet miqësore të elitave që drejtojnë të dy shtetet, duke bazuar në interesa të përbashkëta.

### Koha nuk i zgjidh problemet por ndihmon në shërimin e plagëve

Konfliktet e fundit më të mëdha midis hungarezëve dhe serbëve që u shoqëruan me humbje masive njerëzore si pasojë e dhunës me bazë etnike ndodhën në mesin e viteve 1940, kështu që më shumë se gjysma e shekullit ka kaluar pa konflikte të mëdha midis dy vendeve. Kjo periudhë kohore ndihmoi gjithashtu elitat politike dhe shoqërinë hungareze (të paktën pjesën më madhe) për të kapërcyer sindromën e Trianonit, kështu që qasja revizioniste nuk mund të kthehej në politikën e jashtme hungareze pas ndryshimit të regjimit në fillimin e viteve 1990, çka ishte thelbësore për ndërtimin e besimit midis dy vendeve. Për më tepër, me kalimin e kohës, numri i njerëzve që u prekën drejtpërdrejt nga ato mizori po zvogëlohet, gjë që lehtëson rrethanat e procesit të pajtimit.



## Mbrojtja e pakicave në Hungari dhe Serbi, dhe pozitat e pakicës hungareze

Lufta në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1990 rezultoi në "etnifikimin" e politikës së përgjithshme dhe në këtë mënyrë, përkeqësim të qasjes ndaj pakicave në Serbi, e cila u konsiderua si një faktor potencial paqëndrueshmërie. Qeveritë hungareze ishin të shqetësuara për përkeqësimin e situatës së pakicës kombëtare hungareze në Serbi gjatë kësaj periudhe dhe kjo u shndërrua në një pengesë kryesore për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe. Prandaj, hapi i parë për pajtimin midis dy shteteve dhe dy popujve ishte ndryshimi i politikës ndaj pakicave në Serbi dhe vazhdimi i përmirësimit të kornizës së përgjithshme për pakicat në Hungari, si dhe pjesëmarrja e plotë e elitave të pakicave në sistemin politik të vendit.

Ndryshimi i regjimit në Hungari dhe procesi i integritit euro-atlantik siguruan një atmosferë pozitive për zhvillimin e kornizës së politikës për pakicat në Hungari. Aleanca Demokratike e Serbëve u përfshi në mënyrë aktive në përgatitjen e Ligjit për Pakicat Kombëtare dhe Etnike (i miratuar në 1993), i cili lehtësoi gjithashtu krijimin e organeve të vetëqeverisjes së pakicave në nivelin kombëtar dhe komunal. Në 1995 u themelua organi i vetëqeverisjes së pakicës serbe në nivel kombëtar. Si rezultat i zgjedhjeve në 1998, 34 organe të vetëqeverisjes në nivel lokal u krijuan në Budapest dhe në nivel qarku. Në periudhën 2014-2019, numri i tyre ka qenë 45. U janë siguruar të drejtat kulturore dhe arsimore serbëve dhe pakicave kombëtare të tjera të njohura. Për ruajtjen e kulturës serbe, Kisha Ortodokse Serbe në Hungari luan një rol të rëndësishëm. Kuadri ligjor i përfaqësimit parlamentar të pakicave kombëtare u krijua vetëm në vitin 2010. Në përputhje me ligjin e ri zgjedhor, pakicat kombëtare mund të kenë një përfaqësues në Asamblenë Kombëtare hungareze.

Kursi i përgjithshëm për formësimin e kornizës për mbrojtjen e pakicave në Serbi nisi në fillim të viteve 2000, pas rënies së regjimit të Slobodan Miloseviçit. Si hap i parë, Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) më në fund ratifikoi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Kartën Europiane për Gjuhët dhe Pakicat Rajonale, dhe në vitet në vijim nënshkroi disa marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen e të drejtave të pakicave me vendet fqinje, përfshirë Hungarinë. Sistemi aktual i mbrojtjes së pakicave kombëtare bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të vitit 2002 (i ndryshuar në 2009 dhe 2013), tek Kushtetuta e 2006, tek Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare (i ndryshuar në 2014) dhe tek Ligjin kundër Diskriminimit i vitit 2009. Serbia ka miratuar gjithashtu një sërë ligjesh që përcaktojnë më tej disa nga të drejtat e pakicave kombëtare, përfshirë Ligjin për Përdorimin Zyrtar të Gjuhës dhe Shkrimin, Ligjin për Kulturën të vitit 2009, Ligjin për tekstet shkollore dhe materiale të tjera mësimore të 2009, etj. Kthesë demokratike në Serbi lejoi gjithashtu miratimin e Marrëveshjes dypalëshe për mbrojtjen e pakicave midis Hungarisë dhe Serbisë në 2003.

Kushtetuta dhe ligjet parashikuan rregulla specifike për pakicat kombëtare për të siguruar një barazi të plotë dhe për t'i ndihmuar ata në ruajtjen e identitetin e tyre. Atopërcaktuan që pakicat kombëtare gëzojnë autonomi kolektive në fushat e mëposhtme: a) kultura: pakicat kombëtare kanë të drejtë të "krijojnë institucione, shoqëri dhe shoqata specifike

kulturore, artistike dhe shkencore”; b) arsimimi: e drejta për arsimim në gjuhën e tyre amtare në “nivelet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm”, c) informimi: e drejta për informacion të plotë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre amtare dhe shteti është i detyruar të sigurojë “informacion, përmbajtje kulturore dhe arsimore”; d) përdorimi i gjuhës zyrtare dhe shkrimi: në komunat ku pakicat kombëtare përbëjnë më shumë se 15% të popullsisë, gjuha dhe shkrimi i pakicave mund të bëhet zyrtarë.<sup>39</sup> Këshillat Kombëtar të Pakicave (KKP), të zgjedhura nga pakica përkatëse që ata përfaqësojnë, janë organet e ngarkuara me vendimmarrjen në këto fusha. Në zgjedhjet në nivel lokal, krahinor dhe shtetëror, partitë e regjistruara si parti të pakicave kombëtare gëzojnë diskriminim pozitiv, pasi ata mund të marrin të paktën një vend nëse lista e tyre prek “pragun natyror” (numri i total pjesëmarrësve i pjestuar me numrin e mandateve në asamblatë lokale, krahinore apo kombëtare) në vend të pragut të rregullt prej 5 përqind.

Sipas censusit të vitit 2011, numri i hungarezëve ishte rreth 250 mijë në Serbi (3.53 përqind e popullsisë së përgjithshme, ose 13 përqind e popullsisë në Vojvodinë), e cila jeton kryesisht në Vojvodinë.<sup>40</sup> Pakica hungareze në Serbi është një nga më të mirë-organizuarat dhe me lidhjet më të mira me autoritetet qendrore. Për gati dy dekada përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në pothuajse të gjitha maxhorancat e pushtetit në nivel qendror dhe në nivelin e Krahinës së Vojvodinës, dhe në një numër komunash në KAV, duke i lejuar atyre të ndikojnë ndjeshëm në hartimin dhe ndryshimet kryesore të akteve që rregullojnë kornizën e mbrojtjes së pakicave në Serbi. KKP-ja i parë hungarez u zgjodh në 2002 nga një komitet zgjedhësish, ndërsa zgjedhjet e para të drejtpërdrejta u mbajtën në vitin 2010. Kuadri ligjor është përmirësuar më tej si rezultat i procesit të integritimit në BE dhe presionit të ardhur nga vendet anëtare të BE-së, përfshirë Hungarinë (shiko më poshtë).

Ndërsa këto përmirësime janë të mirëpritura nga të dy palët, korniza aktuale e rregullimit mund të shërbejë si bazë për segregim. Politika e pakicave duhet të inkurajojë gjithashtu integrimin e pakicave në shoqërinë më të gjerë, kështu që ka akoma hapësirë për përmirësime. Një nga metodat më të mira është gjetja e zgjidhjeve për zbatimin e qasjes ndërkulturore brenda politikës së pakicave, e cila do ta shndërronte në një proces të një rruge me dy kahe (d.m.th. duke përfshirë si pakicën dhe shumicën) për zbatimin e plotë të politikës dhe standardeve për pakicat. Kjo qasje është advokuar në mënyrë aktive nga shoqëria civile në Serbi.

### Bashkëpunimi pas vitit 2008 - Integrimi në BE i Serbisë dhe më tutje

Marrëdhëniet Serbi-Hungari u përmirësuan pas ndryshimit të regjimit në Beograd në 2000, dhe ato po rriteshin në mënyrë të vazhdueshme, përpos disa “hileve” për shkak të

---

<sup>39</sup> Në Krahinën Autonome të Vojvodinës, vendbanimet individuale, pjesë e bashkive, mund t'a përfitojnë këtë nëse 25% e popullsisë është nga pakica.

<sup>40</sup> Statistical Office of the Republic of Serbia, “2011 Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Serbia”, Belgrade 2014, <https://publikacije.stat.gov.rs/G2014/PdfE/G20144012.pdf>, [1 Nëntor 2019].

incidenteve ndëretnike në Vojvodinë<sup>41</sup>, mungesës së mirëkuptimit në lidhje me interpretimin e ngjarjeve të caktuara historike,<sup>42</sup> dhe nocioneve të paqarta ku hungarezët e Vojvodinës mund të kërkojnë një autonomi territoriale në 8 komuna (ose 10, në varësi të versionit) në veri të Serbisë, ku ata përbëjnë shumicën.<sup>43</sup> Megjithatë, për shkak të shpalljes së pavarësisë së Kosovës në 2008 dhe njohjes së saj nga hungarezët, marrëdhëniet arritën nivelin më të ulët ndër vite. Sidoqoftë, të dy shtetet e tejkaluan krizën shpejt përmes një qasje pragmatike bashkëpunimi, bazuar në integrimin në BE, ku bëhet thirrje për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe çështje të sigurisë. Serbia, e cila në atë kohë po kërkonte të bëhej kandidat për në BE, kishte nevojë për mbështetjen e Hungarisë. Një nga hapat e parë ishte një marrëveshje dypalëshe për mbrojtje dhe siguri, e cila përcaktoi kornizën e bashkëpunimit në këtë fushë dhe u pasua menjëherë me Serbinë që ju bashkua misionit paqeruajtës hungaro-slllovak në Qipro. Gjithashtu, ajo ishte themeli i ushtrimeve të përbashkëta ushtarake, dhe deri më sot nga të gjitha vendet anëtare të NATO-s, Serbia kishte numrin më të madh të ushtrimeve dypalëshe me Hungarinë dhe Rumaninë. Gjatë presidencës së saj të BE-së në 2011, Hungaria ishte shumë mbështetëse e kërkesës së Serbisë për në BE, e cila hapi rrugën për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE në 2012. Serbia gjithashtu mbështeti hartimin e Strategjisë së Danubit. Bashkëpunimi ndërkuftar midis dy shteteve brenda kornizës së BE-së është shumë aktiv dhe shumica e fondeve zakonisht përdoren.

Sidoqoftë, mbështetja e Hungarisë nuk ishte e pakushtëzuar, pasi varej nga zbatimi nga Serbia i kornizës së saj të politikës për pakicat dhe nga qasja në përgjithësi ndaj pakicës hungareze. Për shembull, Hungaria kushtëzoi kandidaturën e Serbisë në 2012 me ndryshimet në projektligjin për kthimin e pronave të kolektivizuara ndërmjet viteve 1945-1965 ose pagimin e dëmeve, duke insistuar se ajo nuk mund të zbatohet parimin e ndëshkimit kolektiv, i cili, në këtë rast, ishte menduar të aplikohet pothuajse për tërë popullatën etnike hungareze në Serbi. Zgjidhja përfundimisht u gjet përmes konsultimeve politike dypalëshe. Shembulli i dytë është që Hungaria, së bashku me Kroacinë, Bullgarinë dhe Rumaninë, kërkuan një mekanizëm special në lidhje me mbrojtjen e pakicave në Serbi në kuadër të Kapitullit 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), i cili rezultoi në krijimin e një plani të veçantë veprimi për zbatimin e të drejtave të pakicave. Serbia miratoi planin e veprimit në 2016 dhe nisi zbatimin e tij, në koordinim me këshillat kombëtar të pakicave.

---

<sup>41</sup> Për shembull, Vukmirović, Đ., and Preradović Lj.. "Nacionalni sukobi tresu Temerin." *Vecernje Novosti*, <http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:346843-Nacionalni-sukobi-tresu-Temerin>, [4 Shtator 2019].

<sup>42</sup> Për shembull, kur Presidentit hungarez iu kërkua që të mos merrte pjesë në festimet e revolucionit të 1848, të organizuara nga Aleanca e Hungarezëve të Vojvodinës. Shiko "Tadić i Šoljom naljutili vojvodanske Mađare." *Autonomija*, <http://www.autonomija.info/tadic-i-soljom-naljutili-vojvodanske-madare.html>, [4 Shtator 2019]. Shembulli tjetër është ripërtëritja e gjykimit të Sandor Kepiro, një ish-oficer ushtarak hungarez që mori pjesë në mizoritë e luftës (sipas vendimeve të gjykatës në vitet 1940, gjatë regjimit të Horthy-t) në qytetin e Novi Sadit në 1942, i cili u deklarua i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë në 2011. Zyrtarët serbë, në veçanti kryebashkiaku i Novi Sadit, u zhgënjyen nga një vendim i tillë. Shiko Zori, Ognjen. "Presuda Kepiru šokantna, najavljene žalbe." *Radio Slobodna Evropa*, <https://www.slobodnaevropa.org/a/presuda-kepiru-sokantna-najavljene-zalbe/24270357.html>, [4 Shtator 2019].

<sup>43</sup> Shiko "Vojvodanski Mađari o autonomiji Vojvodine." *Autonomija*, <https://www.autonomija.info/vojvodanski-madari-o-autonomiji-vojvodine.html>, [4 Shtator 2019].

## Forcimi i bashkëpunimit ndërqeveritar dhe ndërpartiak

Avancimi më i madh erdhi pas ardhjes në pushtet në Serbi të Partisë Progresiste Serbe (Srpska napredna stranka, SNS), dhe me farkëtimin e ngadaltë të partneritetit të tyre me Aleancën e Hungarezëve të Vojvodinës (Savez vojvođanskih Mađara, SVM), partia më e madhe e pakicës në Serbi. Që në 2010 duket se SVM-ja ka luajtur një rol kryesor në krijimin e lidhjeve midis Fidesz (partia qeverisëse në Hungari që prej pranverës së 2010) dhe SNS-së.<sup>44</sup> Ky ndërmjetësim i hershëm i mirëkuptimit midis Fidesz dhe SNS-së dha shpejtë frytet sapo SNS-ja mori pushtetin në Serbi. SVM-ja nuk mori pjesë në qeverinë e parë të SNS-së, kryesisht për shkak të mungesës së mirëkuptimit midis SNS-së dhe partnerëve të tjerë të koalicionit, por të dy partitë tashmë kanë formuar një partneritet, dhe SVM-ja dhe SNS-ja u bënë bashkë në qeveri që pas zgjedhjeve që pasuan.

Ajo çka ishte e vështirë për t'u miratuar nga qeveritë liberale, u arrit shpejt nga dy liderët e krahut të djathtë, nga kryeministri/presidenti Aleksandar Vuçiç dhe kryeministri Viktor Orban. Të dy kryetarët e shteteve, Janos Ader dhe Tomislav Nikoliç, u takuan në Budapest në nëntor 2012, ku ata njoftuan një fillim të ri të marrëdhënieve dhe diskutuan gjithashtu çështje të ndjeshme si rasti i djemve të Temerinit<sup>45</sup>. Në qershor 2013, Parlamenti i Serbisë miratoi deklaratën që dënonte aktet kundër popullatës civile hungareze në Vojvodinë, të kryera nga viti 1944 deri në 1945. Disa ditë më vonë, Janos Ader, Presidenti i Hungarisë, mbajti një fjalim në Parlamentin serb ku dënoi gjithashtu mizoritë e kryera nga miliciet hungareze kundër civilëve serbë në Luftën e Dytë Botërore.<sup>46</sup> Që atëherë, u mbajtën disa aktivitete përkujtimore dhe nderime me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë të të dy shteteve. Viktor Orbani inauguroi një qendër kulturore në Beograd në 2014. Këto akte simbolike hapën një rrugë për pajtim midis elitave të dy shteteve, si dhe për një bashkëpunim të ngushtë midis dy qeverive.

Aktet simbolike u pasuan nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet qeverive. Që prej 2014, mbledhje të përbashkëta të qeverive janë organizuar rregullisht për të lehtësuar zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe në fusha të ndryshme, përfshirë ekonominë, bujqësinë, infrastrukturën, lehtësimin e investimeve, kulturën dhe arsimin. Këto takime gjithashtu synojnë të përcaktojnë planet e punës për të mbështetur procesin e integritit të Serbisë në BE. Falë bashkëpunimit të forcuar, shkëmbimet tregtare dypalëshe u rritën nga 1.4 miliardë në 2.5 miliardë euro nga 2013 në 2017. Në dallim nga Sllovakia dhe Rumania, Serbia i pranoi me gatishmëri nismat e Budapestit për t'i dhënë nënshtetësinë hungareze

---

<sup>44</sup> Laketiç, M. "Pastor i Nikolić zajedno u Budimpešti." Blic.rs, <https://www.blic.rs/vesti/politika/pastor-i-nikolic-zajedno-u-budimpesti/j82sk14>. [4 Shtator 2019]. Në atë moment, SVM-ja ishte kryesisht në koalicion (në nivel lokal, krahinor dhe qendror) me Partinë Demokratike të Serbisë, si partneri i tyre afatgjatë. Gjithsesi, pati një trend të dallueshëm të transformimit të SVM-së nga social-demokracia zyrtare drejt një partie të qendrës së djathtë, i cili hapi rrugën për afrimin midis Fidesz-it dhe SNS-së.

<sup>45</sup> Pesë burra të rinj hungarez dhunuan rëndshëm një burrë serb (i cili po i provokonte ata për shkak të kombësisë) në Temerin në 2004 dhe u dënuan me gjithsej 61 vite burg. Qeveria hungareze loboi për lehtësim të gjykimeve, e cila ndodhi pjesërisht falë ligjit për amnistinë.

<sup>46</sup> "Magyar bocsánatkérés a szerb parlamentben." *Múlt-kor*, [https://mult-kor.hu/20130626\\_magyar\\_bocsanatkeres\\_a\\_szerb\\_parlamentben](https://mult-kor.hu/20130626_magyar_bocsanatkeres_a_szerb_parlamentben) [7 Shtator 2019].

hungarezëve etnikë në Vojvodinë.<sup>47</sup> Si një shtet me pakica të konsiderueshme në shtetet fqinje, Serbia është mësuar të dyfishojë nënshtetësinë e qytetarëve të saj (Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni e Veriut, etj.), dhe nuk e sheh atë si një kërcënim për sovranitetin e saj. Ajo gjithashtu e lejoj qeverinë hungareze që të mbështeste drejtpërdrejt institucionet dhe mediat hungareze në Vojvodinë, dhe të niste një program të zhvillimit ekonomik për Vojvodinën. Bashkëpunimi i ngushtë i qeverive gjithashtu e bëri më të lehtë tejkalimin e disa situatave kontradiktore. Veçanërisht interesante ishte pranimi i politikës hungareze gjatë krizës së migracionit në 2015 dhe i ngritjes së gardhit në kufirin Serbi-Hungari, megjithëse Serbia ishte një nga vendet kryesore të tranzitit.

Bashkëpunimit në nivel qeveritar i është mbivendosur bashkëpunimit në nivel partish. SNS i lejoi Fidesz-it të kryejë fushata politike në Serbi para zgjedhjeve hungareze, por në këmbim partia qeveritare hungareze mbështeti hapur SNS-në në fushatat e saj zgjedhore. Afërsia politike e Fidesz-it dhe SVM-së nuk ishte gjithashtu një problem, dhe në 2014, një qytetar serb, Andor Deli (anëtar i SVM-së), ish-sekretari i Vojvodinës për arsimin, administratën dhe bashkësitë kombëtare, u bë anëtar i Parlamentit European me mandatin hungarez.

Shumë kritikojnë marrëdhënien e ngushtë midis dy qeverive, kryesisht për shkak të stilit të sundimit joliberal të të dy liderëve, Vuçiç dhe Orban. Disa e shohin këtë bashkëpunim si oportunist, me Serbinë që përfiton mbështetje për integrimin në BE dhe investime nga Hungaria, ndërsa Budapesti që përfitoi një partner që nuk kundërshton nismat e tij në lidhje me pakicat hungareze në shtetet fqinje.<sup>48</sup> Sidoqoftë, aktualisht situata është e dobishme, ku në dukje nuk ekzistojnë keqkuptime dhe përplasje politike midis dy shteteve, dhe një nga frikërat më të mëdha në Serbi ku hungarezët e Vojvodinës do të avancojnë në drejtim të autonomisë territoriale duket se mbetet jashtë tryezës. Hungaria mbështet fuqimisht integrimin në BE të Serbisë, dhe nganjëherë zyrtarët e saj publikojnë deklarata shumë të forta në lidhje me trajtimin e Serbisë nga shtetet e tjera anëtare dhe institucionet e BE-së.<sup>49</sup>

Në total, niveli aktual i marrëdhënieve midis dy vendeve mund të përshkruhet si më i miri në historinë moderne, por mbetet pyetja nëse “pajtimi politik” po përkthehet në “pajtim shoqëror”. Ndërsa ka përafrimi simbolik të narrativave historike, as historianët dhe as Komisioni Akademik Ndërshtetëror i Përzjerë për krimet e luftës kundër civilëve në vitet 1941-1948, që u krijua në 2010, nuk kanë arritur t’a mbyllnin çështjen. Padyshim që numri i incidenteve ndëretnike ka rënë në mënyrë dramatike. Nga ana tjetër, çështja e ngurtë e

---

<sup>47</sup> Për pasardhësit e qytetarëve të Austro-Hungarisë përpara vitit 1918, të cilët mund të provojnë se ata mund të flasin gjuhën hungareze.

<sup>48</sup> Për shembull, shiko Milošević, Ana. “Cinične igre Srbije i Mađarske oko prošlosti.” *Balkan Insight*, <https://balkaninsight.com/2018/04/06/cinične-igre-srbije-i-mađarske-oko-prošlosti-04-05-2018/?lang=sr> [4 Shtator 2019].

<sup>49</sup> Shiko “Sijarto: Evropska komisija veštački usporava integraciju srbije u EU.” *Politika Online*. <http://www.politika.rs/sr/clanak/427455/Sijarto-Evropska-komisija-vestacki-usporava-integraciju-Srbije-u-EU>, [4 Shtator 2019] ose “Sijarto: Srbija što pre da postane članica, 2025. Dalek Datum.” *Radio Television of Serbia*, <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/politika/3213715/sijarto-srbija-sto-pre-da-postane-clanica-2025-dalek-datum.html>, [4 Shtator 2019].

segregimit de fakto të pakicave më të mëdha në Serbi, përfshirë hungarezët, mund të paraqesi një problem në të ardhmen.

## **Konkluzione**

Procesi i pajtimit serbo-hungarez arriti rezultate të rëndësishme në drejtim të bashkëpunimit të qeverive dhe partive dominuese. Përkatësisht, ky proces mund të konsiderohet më tepër si një qasje nga lart-poshtë, në të cilën partitë politike luajtën një rol thelbësor, përfshirë rolin lehtësues të SVM-së. Ndërtimi i besimit në nivel shtetëror dhe partiak mundësoi jo vetëm zhvillimin e kornizës së politikës së pakicave dhe zbatimin më të mirë të saj, por lehtësoi gjithashtu edhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik, politik, arsimor dhe kulturor. Ndihma e ndërsjellë për mbrojtjen e pakicave për hungarezët në Serbi dhe serbët në Hungari ishte thelbësore për ndryshimin e rrjedhës së bashkëpunimit dypalësh. Leva e Hungarisë është forcuar ndjeshëm nga procesi i integritimit në BE. Nga njëra anë, vetë korniza e integritimit në BE siguron stimuj të fortë për reforma, por meqenëse secili hap i procesit të anëtarësimit kërkon mbështetjen e të gjitha shteteve anëtare, shtetet anëtare mund të bëjnë presion të madh mbi kandidatët (potencialë).

Gjithësesi, është e diskutueshme se si një qasje e tillë nga lart-poshtë mund të funksionojë në periudhën afatgjatë. Megjithatë pozicioni i të dy partive në pushtet është i qëndrueshëm, është e rëndësishme të sigurohet që procesi i pajtimit të mos mbështetet vetëm tek vullneti politik i politikanëve kryesorë. Prandaj, aspektet shoqërore të pajtimit duhet të marrin më shumë vëmendje në të ardhmen. Përfundimisht, besimi midis qytetarëve mund të krijojë një mjedis jetese të sigurt dhe të qëndrueshëm së bashku me mundësi më të mira ekonomike dhe të tregut të punës.

Kuadri i politikës së pakicave ka të ngjarë gjithashtu që të sfidohet së shpejti nga ndryshimet demografike. Arsyet kryesore janë plakja e popullsisë dhe emigrimi për në Hungari dhe Europën Perëndimore. Emigrimi u bë më i lehtë për shkak të politikës së dhënies së nënshtetësisë nga qeveria hungareze për hungarezët etnikë jashtë vendit, kështu që është e mundshme që numrat të jenë edhe më të ulët sot sesa në vitin 2011 (rreth 40 mijë hungarezë tashmë u larguan nga vendi në vitet 2000 për shkak të mjedisit të pafavorshëm dhe për mundësi më të mira jashtë vendit) dhe censusi i ardhshëm i vitit 2021 do të tregojë më shumë mbi këtë gjë.

## **Rekomandime për Hungarinë dhe Serbinë**

- Rekomandimet fokusohet tek forcimi i aspekteve shoqërore (ndërtimi i besimit midis qytetarëve) të pajtimit.
- Të dy qeveritë mund të alokojnë më shumë burime për shkëmbimet e të rinjve midis pakicave dhe shumicës. Një program i përhershëm mund të themelohet për këtë qëllim.

- Reforma e politikës së pakicave në Serbi gjithashtu duhet të forcojë elementet ndërkulturore që gjithashtu mund të forcojnë marrëdhëniet mes qytetarëve dhe të përmirësojnë integrimin.
- Mbështetja dhe fokusi më i fuqishëm në punën e Komisionit Akademik Ndërshtetëror të Përzjerë mund të inkurajojë përafrimin e narrativave historike, të cilat gjithashtu mund të lehtësojnë zbatimin më të mirë të politikës së pakicave (për shembull: ligji për rehabilitimin).
- Deri më tani, kryesisht partitë dominuese kanë luajtur rolin kryesor në përcaktimin e politikës për pakicat. Zgjerimi i mbështetjes shoqërore për ato zgjidhje mund të rrisë pronësinë mbi kornizën e politikës për pakicat.

### **Mësime për Ballkanin Perëndimor**

- Rasti serb dhe hungarez sugjeron që ndryshimi i narrativës në lidhje me “palën tjetër” është thelbësor për pajtimin. Me fjalë të tjera, hapi i parë i pajtimit duhet t’i japë fund praktikës së përmendjes së tensioneve historike në lidhje me “palën tjetër”, si një argument për betejat e brendshme politike. Kjo do të ndihmonte në relaksim të atmosferës politike aktuale dhe në forcimin e komunikimit midis dy palëve.
- Ky rast sugjeron gjithashtu që integrimi i pakicave në shoqërinë e gjerë duhet të mbështetet përmes politikave inovative të pakicave, në përputhje me standardet më të mira europiane.
- Njohja e viktimave nga pala tjetër në konfliktin e kaluar është gjithashtu e rëndësishme për pajtimin, pasi ajo mundëson një rrugë drejt adoptimit të një narrative të vetme dhe të përbashkët për të kaluarën, duke eliminuar kështu një pikë tjetër fërkimi të përbashkët.
- Së fundmi, nuk ka asnjë proces pajtimi pa qasjen nga lart-poshtë - domethënë, është përgjegjësia e politikanëve të njohin se ku janë pikat e fërkimit, dhe nëse ato do të adresohen varet nga vullneti i tyre politik. Sidoqoftë, në raste avancimi, politikanët dhe liderët gjithashtu duhet të bëjnë presion për qasje nga poshtë-lartë, të cilat do të siguronin që besimi dhe bashkëpunimi midis komuniteteve në fjalë do të ndodhë në terren, ndërsa forcohet pronësia lokale e politikave për pakicat.

# Marrëdhëniet Shqipëri - Serbi: Ura mbi ujërat e trazuar

*Gentiola Madhi, Jelica Minić*

## Hyrje

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Serbisë janë shënuar gjatë dekadave të kaluara nga mungesa e dialogut politik dhe prania e fërkimeve diplomatike. Kjo dobësi është reflektuar në marrëdhëniet midis popujve përkatës. Paçka se janë dy etnitë kryesore në rajon, marrëdhëniet e ndërsjellta janë ende larg nga të qëniet të konsideruara si të pjekura dhe kanë nevojë për praninë dhe ndërmjetësimin e palëve të treta në mënyrë që të sheshohen paragjykimet, mungesa e tolerancës dhe mosbesimi i tejzgjatur.

Fill pas luftës së Kosovës, të dy shtetet rifilluan marrëdhëniet dypalëshe që nga janari 2001 përmes një shkëmbimi të letrave diplomatike. Gjithsesi, marrëdhëniet e ndërsjellta nuk përparuan deri në nëntor 2014, kur Kryeministri Rama vizitoi Beogradin - vizita e parë zyrtare e një lideri shqiptar në Serbi në 68 vjet. Ky akt simbolik dhe historik krijoi një moment të freskët politik dhe shënoi një fillim shpresëdhënës të një cikli të ri të përafërimit politik dhe shoqëror. Vizitat zyrtare në kryeqytetet përkatëse të Ramës dhe Vuçiçit u mbështetën fuqimisht nga aktorë kryesorë ndërkombëtarë si Gjermania, BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara, dhe u organizuan në krahë të të ashtuquajturit Procesi i Berlinit. Gjatë konferencës së parë të përbashkët për shtyp, të dy udhëheqësit politikë ndanë vizionin e tyre se kishte ardhur koha për të çuar përpara marrëdhëniet e ndërsjellta përmes një "qasjeje të unifikuar për një të ardhme më të mirë për popujt tanë"<sup>50</sup>. Në terma teknikë, këto vende nuk kanë ndonjë çështje të hapur dypalëshe. Sidoqoftë, thembra e Akilit dhe çështja më e diskutueshme për të dy mbetet çështja e pavarësisë së Kosovës, e cila nuk mund të përjashtohet nga rendi i ditës kur i referohemi përmirësimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Luhatja e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit sigurisht që ka një efekt të jashtëm në marrëdhëniet midis Serbisë dhe Shqipërisë. Prandaj, zgjidhja e statusit të Kosovës do të kontribuonte në avancimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe stabilitetin e përgjithshëm të rajonit.

Për më tepër, gjatë dekadave të kaluara pengesa të tjera kanë pllakosur afrimin e ndërsjelltë midis Shqipërisë dhe Serbisë. Në veçanti, ka pasur një mungesë angazhimi të vërtetë qeveritar nga të dy palët për të ndërmarrë një proces ndërtimi të besimit dhe proces normalizimi/pajtimi. Mandej, faktori i kohës ka ndikuar tek dinamikat politike të shteteve, duke rezultuar në një mundësi të humbur për të zgjeruar mirëkuptimin e ndërsjelltë, në përputhje me zhvillimet e përgjithshme politike ndërkombëtare. Sfidat kryesore që kanë nxitur perceptimet negative midis shqiptarëve dhe serbëve mbështeten tek armiqësia e historike, retorika nacionaliste, interpretimi i ndryshëm dhe instrumentalizimi i të kaluarës nga elitat politike, paragjykimet e ndërsjellta të ngritura

---

<sup>50</sup> "Albania's premier makes historic visit to Belgrade", DW, <https://www.dw.com/en/albanias-premier-makes-historic-visit-to-belgrade/a-18051456>, [31 Tetor 2019].



nga mungesa e njohurive dhe e ndërveprimeve mes njeri-tjetrit, keqkomunikimi, etj. Në veçanti, arsimi është ndikuar dhe keqpërdorur për përjetësimin e stereotipeve midis disa brezave.

Sot Shqipëria dhe Serbia duhet të investojnë më shumë në zhvillimin e një vizioni të përbashkët për të ardhmen. Në këtë drejtim, perspektiva e pranimit në BE parashikon një ambicie kolektive jo vetëm për këto dy vende, por për të gjithë rajonin, dhe mund të shërbejë si një shtysë për një proces pajtimi të gjerë dhe të qëndrueshëm. Në fakt, Samiti i Selanikut në 2003 i ofroi rajonit një perspektivë europiane, dhe që atëherë vendet kanë bërë disa hapa përpara. Së fundmi, Komisioni European e përfshiu pajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe ekzistuese tek prioritetet udhëheqëse (flagship) në strategjinë e tij të fundit për zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor. Kjo lëvizje përbën një hap përpara në priorizimin e procesit të pajtimit, përveç të qenit një kushtëzim shtesë për shtetet. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të forcojnë përpjekjet e tyre kolektive për të përmirësuar marrëdhëniet e ndërsjellta dhe të përgatiten për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit.

Kundrejt këtij sfondi, ky punim synon të identifikojë hapat kryesorë që janë bërë në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Serbisë që prej kthesës së liderëve në 2014. Qëllimi i përgjithshëm është të reflektojë mbi mësimet e nxjerra gjatë pesë viteve të shkuara dhe të sigurojë rekomandime se si të nxitet më tej ky momentum i bashkëpunimit të krijuar rishtazi dhe të investohet në një proces pajtimi më të qëndrueshëm dhe mes shumë nivelesh.

### **Përafrimi dypalësh: njëri hap pas tjetrit**

Procesi i normalizimit/pajtimit midis Shqipërisë dhe Serbisë duhet të shihet nga një perspektivë shumë-dimensionale, e cila siguron hapësirë për të mësuar nga dështimet e së kaluarës dhe për të marrë masat e përshtatshme për adresimin e pengesave ekzistuese në nivel dypalësh. Korniza e Procesit të Berlinit ka krijuar një hapësirë për këto vende që të takohen shpesh në raste të ndryshme dhe të adresojnë marrëdhëniet dypalëshe dhe afrimin mes shoqërive nga një perspektivë më e gjerë rajonale. Kjo qasje e zgjeruar ka siguruar një hapësirë më të gjerë negocimi dhe ka kontribuar në nxitjen e bashkëpunimit dypalësh në fusha të reja politikash, të cilat bien posaçërisht në sferën e politikave të buta (soft policy). Gjatë pesë viteve të fundit, midis Shqipërisë dhe Serbisë janë nënshkruar katër marrëveshje të reja dypalëshe në fushën e rinisë, kulturës, turizmit dhe statistikave dhe disa prej tyre kanë siguruar tashmë një historik të zbatimit.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Serbisë është vendosur që në 1926, dhe numri i dokumenteve ndërshtetërore ndërsektoriale arrin në 66 (qofshin këto marrëveshje, konventa, protokolle, etj.), përfshirë gjithashtu edhe ato të nënshkruara midis Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë. Me rivendosjen e dialogut të rregullt në fillim të viteve 2000, marrëveshjet e reja u nënshkruan në përputhje me agjendat europiane të të dy vendeve, si në fushën e evazionit të taksimit të dyfishtë, mbrojtjes së investimeve, luftës kundër

krimit të organizuar, ripranimit, etj. Vetëm në vitin 2006, pas shkëputjes së Malit të Zi, Shqipëria mund të nënshkruante marrëveshje ndërshtetërore ekskluzivisht me Serbinë.<sup>51</sup>

Sipas censusit në Serbi në 2011, ekzistojnë 21 pakica kombëtare<sup>52</sup>, përfshirë edhe shqiptarët. Serbia ka në fuqi rregullore për pakicat kombëtare në përputhje me standardet moderne europiane<sup>53</sup>. Pakica shqiptare ka Këshillin e saj të Pakicës Kombëtare Shqiptare<sup>54</sup> që përfaqëson interesat e saj dhe siguron zbatimin e të drejtave të saj. Në Shqipëri njihen me ligj nëntë pakicat kombëtare, përfshirë atë serbe. Ekzistojnë tre shoqata të regjistruara të serbëve dhe, të serbëve dhe malazezëve. Në tetor 2017, u miratua një Ligj kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare<sup>55</sup>, i ndjekur nga miratimi i 5 akteve nënligjore përkatëse në maj 2019<sup>56</sup> dhe me aktet e tjera nënligjore në procedurë e sipër. Statusi i pakicave kombëtare po përmirësohet në të dy vendet nën monitorimin e përhershëm të institucioneve kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare.

Ajo nga çka vuan ky kuadër bashkëpunimi dypalësh edhe sot nuk është sasia e marrëveshjeve apo diferencimi i sektorëve të politikave, por prania e një strategjie zbatimi dhe i vullnetit politik që zgjat përtej mandatit të liderëve që kanë nënshkruar ato marrëveshje. Për momentin, janë në gjendje disa projekt-marrëveshje dypalëshe të gatshme për t'u nënshkruar, siç janë planifikimi dhe zhvillimi urban apo trafiku rrugor ndërkombëtar, të cilat nuk janë përfunduar për shkak të luhatjes së përkushtimit dhe entuziazmit të shteteve. Lëkundjet në marrëdhëniet kontraktuale mbeten peng i zhvillimeve politike në nivel rajonal; ndaj, nevojitet kohë shtesë për të krijuar një mentalitet fleksibël dhe pragmatik për të adresuar çështje të ngutshme dhe me përfitime të ndërsjellta.

## Përafrimi ekonomik

Duke u ndalur veçanërisht tek bashkëpunimi ekonomik, me hyrjen në fuqi të regjimit të tregtisë së lirë (CEFTA) në 2006, tregtia e ndërsjellë përjetoi një momentum. Shkalla vjetore e rritjes në tregtinë e ndërsjelltë të mallrave dhe shërbimeve është e lartë, veçanërisht për shërbimet. Ka investime të ndërsjellta të individëve dhe ndërmarrjeve nga të dy shtetet, të cilat ndonëse të pakta, vazhdojnë të rriten në mënyrë të vazhdueshme. Sektori i biznesit ndjek normat dhe parimet e veta, duke u distancuar në një farë mase nga retorika politike, dhe duke kontribuar kështu në lehtësimin e ndërveprimeve midis

---

<sup>51</sup> Simurdic M., "Srpsko-albanski odnosi", European Movement in Serbia, [www.arhiva.emins.org/uploads/useruploads/dokumentipdf/Srpsko-albanski-odnosi---Simurdic-15-07-2016-.pdf](http://www.arhiva.emins.org/uploads/useruploads/dokumentipdf/Srpsko-albanski-odnosi---Simurdic-15-07-2016-.pdf), [31 Tetor 2019].

<sup>52</sup> "Rezultati popisa stanovništva, Srbija 2011", Vreme, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1157758>, [31 Tetor 2019].

<sup>53</sup> "Zakon o zaštiti prava i sloboda nacionalnih manjina", online at [https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_zastiti\\_prava\\_i\\_sloboda\\_nacionalnih\\_manjina.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_zastiti_prava_i_sloboda_nacionalnih_manjina.html), [31 Tetor 2019].

<sup>54</sup> "Zakon o nacionalnim savetima nacionalnih manjina", online at [https://www.paragraf.rs/propisi/download/zakon\\_o\\_nacionalnim\\_savetima\\_nacionalnih\\_manjina.pdf](https://www.paragraf.rs/propisi/download/zakon_o_nacionalnim_savetima_nacionalnih_manjina.pdf), [31 Tetor 2019].

<sup>55</sup> European Commission, "Albania 2018 Report", <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>, [31 Tetor 2019].

<sup>56</sup> European Commission, "Albania 2019 Report", <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>, [31 Tetor 2019].

qytetarëve të të dy vendeve. Disa kompani të përbashkëta janë krijuar dhe klima e biznesit për bashkëpunim mes komuniteteve përkatëse të biznesit konsiderohet si e favorshme. Megjithëse tregtia bazohet në produktet me vlerë të shtuar të ulët, pritjet që zgjerimi i punimeve në fushën e ndërtimit në të dy shtetet të kontribuojë në avancimin e strukturës së saj dhe të nxisë shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve më të sofistikuar.

Themelimi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë shqiptaro-serbe në 2016 shënon një hap pozitiv përpara. Ai lehtëson qarkullimin midis komuniteteve të biznesit, shkëmbimin e informacionit, organizimin dhe pjesëmarrjen në panaire dhe forume biznesi, dhe eksplorimin e mundësive për të aplikuar me projekte të përbashkëta për financim nga programe të ndryshme europiane.

Një fushë premtuese për bashkëpunim është turizmi, pasi ka një interes dhe potencial në rritje për të dy vendet. Vendosija e një linje të drejtpërdrejtë fluturimi midis dy kryeqyteteve në 2014 ka kontribuar në rritjen e turizmit. Në 2017, numri i qytetarëve serbë që vizituan Shqipërinë ishte afërsisht 5.000.<sup>57</sup> Vitin e kaluar, të dy vendet nënshkruan një marrëveshje pesë-vjeçare bashkëpunimi për turizmin, e hartuar për të tërhequr turistët e huaj, për të promovuar bashkëpunimin midis organizatave të turizmit dhe për të rritur trafikun turistik dypalësh. Ambicia e përbashkët mbetet krijimi i një strategjie të përbashkët turistike, e cila përfshin edhe vendet e tjera të rajonit.

Në nivel rajonal, të dy vendet janë anëtare të më shumë se 50 organizatave rajonale.<sup>58</sup> Në funksion të anëtarësimit të ardhshëm në BE, strukturat rajonale mbeten faktori kryesor detyrues në Ballkanin Perëndimor, duke siguruar hapësirën e nevojshme për "normalitet" në këtë rajon të trazuar, ku aktorë të ndryshëm janë në gjendje të njohin interesat e përbashkëta dhe të angazhohen për t'i realizuar ato - duke kaluar nga sfera ekonomike dhe sociale, tek infrastruktura dhe energjia, mjedisi, etj. Vendosija e taksës nga Kosova prej 100% për eksportet nga Serbia dhe Bosnjë dhe Hercegovina nuk ndikoi në tregtinë midis Serbisë dhe Shqipërisë. Ajo vetëm rriti flukset e paregjistruara të mallrave, të cilat ekzistonin më parë në një nivel më të ulët. Gjithsesi, ky akt çoi në polarizimin e interesave të palëve (Shqipëria mbështet Kosovën dhe Serbisë është bashkë me Bosnjën dhe Hercegovinën) dhe paralizoi punën e CEFTA-s, e cila kishte probleme të brendshme me riorganizimin që më herët. Këto përçarje janë të rrezikshme për punën e organizatave dhe projekteve të tjerë rajonale, në të cilat aktivitetet kishin përparuar më së miri një vit më parë.

Organizatave rajonale ekzistuese si dhe ato të krijuara rishtazi duhet të mbajnë barrën e aktiviteteve të ndërsjellta në mënyrë që t'i afrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor më afër BE-së dhe njëri-tjetrit. Çfarëdo përkeqësim serioz i marrëdhënieve dypalëshe shkakton dëm tek përpjekjet e konsiderueshme që janë bërë për bashkëpunimin rajonal.

---

<sup>57</sup> Rudic F., "Albania, Serbia Team Up to Boost Tourism", Balkan Insight, [www.balkaninsight.com/2018/05/18/albania-serbia-team-up-to-attract-foreign-tourists-05-17-2018](http://www.balkaninsight.com/2018/05/18/albania-serbia-team-up-to-attract-foreign-tourists-05-17-2018), [31 Tetor 2019].

<sup>58</sup> Regional Cooperation Council, "Changing with the Region: RCC Strategy and Work Programme 2017-2019, Annex 1", available at <http://www.rcc.int/admin/files/docs/reports/RCC-Strategy-and-Work-Programme-2017-19-rich.pdf>, [31 Tetor 2019].

## Ndërlidhja mes shoqërive

Fakti që vetëm pas shtatë dekadash të dy vendet shkëmbyen përfundimisht vizitat në nivelin më të lartë dhe vendosën marrëdhënie diplomatike normale pati një ndikim edhe në raportimin në media. Raportimi për politika si kultura, ekonomia dhe turizmi konsiderohet si bartëse e procesit të normalizimit, pavarësisht se referimi i politikës ende i nënshtrohet një mbulimi negativ të mediave nga njëri-tjetri. Ky trend është më i dukshëm në Serbi, ndërsa në Shqipëri raportimi ka tendencë të jetë neutral.<sup>59</sup> Është e rëndësishme të theksohet se liderët politikë ndikojnë në tonin e përgjithshëm të raportimit në media, i cili më pas formëson opinionin e përgjithshëm publik.

Sondazhet e opinionëve të kryera mbi perceptimet e ndërsjellta të marrëdhënieve dypalëshe tregojnë se ekziston një bindje dominante midis qytetarëve që pala tjetër nuk është e gatshme të ndërtojë marrëdhënie miqësore, ndërsa kombi dhe shteti i tij vlerësohen si dashamirës në këtë drejtim.<sup>60</sup> Rëndësia e marrëdhëniet dypalëshe perceptohet si domethënëse për pozicionin e përgjithshëm të secilit shtet si ndërkombëtarisht po dhe rajonal (57% e serbëve dhe 47% e shqiptarëve)<sup>61</sup>, pasi konsiderohet një faktor i rëndësishëm për stabilitetin dhe sigurinë në Ballkan. Shumica e publikut besojnë se thellimi i këtyre marrëdhënive është në interesin më të mirë të të dy vendeve, pavarësisht marrëdhënive të pazgjidhura midis Serbisë dhe Kosovës, dhe qëndrimi i qartë i të dy palëve lidhur me këtë çështje është 'biem dakord që s'biem dakord'. Këto sondazhe tregojnë se mungesa e informacionit dhe njohurive nga të dy palët është një nga pengesat më të forta në ndryshimin e qëndrimeve të thella etnocentrike dhe stereotipeve negative. Bashkëpunimi ekonomik, turizmi dhe shkëmbimet kulturore konsiderohen si sektorët e ndryshimit që mund të kontribuojnë në gjenerimin e normalizimit dhe stabilizimin e marrëdhënive reciproke.

Organizata të ndryshme të shoqërisë civile në të dy vendet kanë punuar ngushtë që nga fillimi i viteve 2000, në mënyrë që të shoqërojnë procesin e normalizimit midis vendeve, të thyejnë armiqësinë ekzistuese dhe paragjykimet dhe të bëhen një kontribues i drejtpërdrejtë i pajtimit mes shoqërive. Ndërsa ky lloj bashkëpunimi ka treguar se është i frytshëm, numri i projekteve të përbashkëta, nismave dhe rrjeteve të OSHC-ve është rritur me kalimin e kohës në fusha të ndryshme.<sup>62</sup> Institucione të ndryshme europiane, shtetet anëtare, si dhe SHBA-ja dhe donatorë të tjerë dypalësh mbështesin përpjekjet e OSHC-ve. Sidoqoftë, është hasur mungesa e vazhdimësisë, strategjisë dhe koordinimit afatgjatë, si dhe shtrirja më e gjerë në nivelin shoqëror.

---

<sup>59</sup> Pavlović A., Čeriman J., "Albania in the Serbian Media (January–September 2017)", European Movement in Serbia, Belgrade 2017, [www.emins.org/wp-content/uploads/2018/09/Albania-in-the-Serbian-Media\\_eng.pdf](http://www.emins.org/wp-content/uploads/2018/09/Albania-in-the-Serbian-Media_eng.pdf), [31 Tetor 2019].

<sup>60</sup> Faktor Plus, "Marrëdhënia midis kombit serb dhe shqiptar, perspektivat e kësaj marrëdhënie, pikat e fërkimit, mundësitë dhe fushat e bashkëpunimit", Beograd, 2018, pjesë e një projekti më të gjerë "Serbët dhe Shqiptarët – Cila rrugë përpara?" që agjencia e lajmeve serbe Tanjug organizoi me agjencinë e lajmeve shqiptare ATSH, me mbështetjen e Ambasadës Norvegjeze në Beograd.

<sup>61</sup> 13% e serbëve dhe 26% e shqiptarëve nuk i konsiderojnë si të rëndësishme. Ibid.

<sup>62</sup> Për shembull: Rrjeti për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan, Konventa Rajonale për Integrimin European, RECOM, Projekti Mundësues për Monitorimin e Reformës në Administratën Publike nga Shoqëria Civile në Ballkanin Perëndimor – ËeBER, SEE Think Net, etj.

Zhvillimi pozitiv është regjistruar pas themelimit të dy organizatave të para ndërqeveritare me pronësi rajonale që synojnë të mbështesin OSHC-të - Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO) dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF). Themelimi i RYCO-s bazohet tek Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunim Rinor që u nënshkrua në nëntor 2014 mes liderëve të Shqipërisë dhe Serbisë. Ai parashikonte krijimin e një dialogu të përhershëm midis të rinjve dhe institucioneve të të dy vendeve. Fillimisht i konceptuar si një instrument dypalësh për të bashkuar brezat e rinj, për të luftuar paragjykimet e ndërsjellta dhe për të forcuar edukimin ndërkulturor, ky memorandum u shndërrua në një gjurmë për një arsim jo-formal rajonal mbi vlerat e përbashkëta në nivel evropian. Memorandumi dypalësh për bashkëpunimin rinor aktualisht zbatohet nga ministritë përgjegjëse për çështjet e të rinjve, me mbështetjen e zyrave të OSBE-së në të dy vendet. Që nga viti 2015, të paktën tetë shkolla verore/dimërore dhe aktivitete trajnuese janë organizuar në Shqipëri dhe Serbi mbi dialogun ndërkulturor dhe vlerat demokratike. Përgjatë tre viteve, më shumë se 2.000 qytetarë kanë shfaqur interes për të marrë pjesë në këto aktivitete dypalëshe,<sup>63</sup> duke shënuar kështu një hap përpara drejt njohjes dhe kuptimit të ndërsjellë.

Ndërkohë, WBF-ja u krijua me mbështetjen e fortë të vendeve të Vishegradit, duke ndjekur shembullin e Fondit Ndërkombëtar të Vishegradit. RYCO dhe WBF-ja mbështeten tek kuotat vjetore të përcaktuara nga qeveritë e rajonit, përpos burimeve të jashtme të financimit. Të dy organizatat kanë arritur të sjellin bashkë organizata lokale (grass-root) nga të gjitha vendet e rajonit, duke rritur shkëmbimin e njohurive dhe ndërlidhjen mes qytetarëve. Në 2018, RYCO pranoi 278 aplikime për projekte, ku 44 aplikantë nga Shqipëria kishin 17 partnerë nga Serbia, dhe 79 aplikantë nga Serbia kishin 32 partnerë nga Shqipëria. Ndërsa vlerësimi paraprak i WBF-së tregon se rreth 60-65% e aplikimeve për projekte apo projekte të miratuara janë dorëzuar bashkarisht nga organizata partnere nga Serbia dhe Shqipëria dhe përqindja është edhe më e lartë për partnerët e OSHC-ve Serbi-Kosovë. Këto shifra tregojnë se organizatat lokale (grass-root) po zgjerojnë rrjetet e tyre dhe duke i afruar të rinjtë me njëri-tjetrin, duke krijuar një gur themeli të ri në procesin e pajtimit.

Sidoqoftë, çfarë nuk është adresuar në këtë panoramë janë pengesat ekzistuese gjuhësore midis qytetarëve. Nxitja e mbështetjes për të mësuar gjuhën shqipe/serbe do të lehtësonte aksesin në informacion, do të forconte komunikimin ndërpersonal dhe do të siguronte një kuptim më të thellë të traditave, kulturës dhe identitetit përkatës. Interesi për gjuhën e vendit tjetër është në rritje, dhe kurse të aksesueshme të gjuhës sigurisht që do të luftonin stereotipizimin negativ të së kaluarës.<sup>64</sup> Në Universitetin e Beogradit ekziston një Departament i Gjuhës Shqipe, themelimi i së cilit daton që në vitin 1925, dhe rreth 10-15 studentë regjistrohen çdo vit në programin e studimit. Tre vite më parë, pas themelimit të shoqatës Klubi Kulturor Shqiptar në Serbi, u organizua një kurs i gjuhës

---

<sup>63</sup> OSCE, "OSCE Presence in Albania brings young people from Western Balkans together in third edition of Youth Trail", available at: [www.osce.org/presence-in-albania/420851](http://www.osce.org/presence-in-albania/420851), [31 Tetor 2019].

<sup>64</sup> Salihu F., "Learning each other's language", Kosovo 2.0, <https://kosovotwopointzero.com/en/learning-each-others-language>, [31 Tetor 2019].

shqipe dhe më shumë se 50 persona u regjistruan menjëherë.<sup>65</sup> Ndërsa në Shqipëri këto mundësi ende mungojnë, pavarësisht interesit të fortë të treguar jo vetëm nga të rinjtë dhe aktivistë të shoqërisë civile, por edhe qytetarë të thjeshtë që kanë një interes të mprehtë për të thelluar njohuritë e tyre për rajonin.

Fenomeni i martesave ndëretnike është një kontribues i drejtpërdrejtë në krijimin e lidhjeve ndërkulturore. Historitë e jetës tregojnë se shtetet janë shumë më afër sesa tregojnë sondazhet publike. Sipas dëshmimeve jozyrtare të ndërmjetësuesve që lehtësojnë martesat në disa pjesë të Serbisë, në zonën nga Beogradi deri në Piro, gjatë periudhës 2012-2017, pati rreth 500 martesat të meshkujve serbë me femrat shqiptare (kryesisht nga Shkodra dhe rrethina e saj, dhe nga Tirana).<sup>66</sup> Shumë familje nga Serbia dhe Shqipëria vazhdimisht komunikojnë dhe vizitojnë njëri-tjetrin. Nusët shqiptare janë shumë të respektuara si nëna të mira, shtëpiake të zellshme dhe që i përshtaten mjedisit shoqëror. Shumica e zonjave shqiptare janë katolike (70%), por edhe të besimit musliman (30%) që zakonisht janë konvertuar në besimin ortodoks. Është interesante që pjesa më e madhe e raportimeve në media për këto martesat është pozitive.

Së fundmi, janë bërë hapa përpara edhe në drejtim të bashkëpunimit kulturor, duke kontribuar në zhvillimin e kanaleve të mirëkuptimit të ndërsjelltë, dialogut dhe njohurive të bazuara në 'ngjashmëri' dhe jo në 'tjetërsi'<sup>67</sup>. Edhe pse përpjekje shtesë janë ende të nevojshme për të zbuluar fusha të përbashkëta që bashkojnë vendet, ekzistojnë disa dëshmi për një interes në rritje për të mësuar më shumë për artin dhe letërsinë përkatëse. Autorë të ndryshëm nga të dy vendet janë botuar në gjuhët përkatëse, siç janë Ismail Kadare, Dragan Velikić, Svetislav Basara, etj. Ministria e Kulturës shqiptare i ka dhënë rëndësi të veçantë në këtë drejtim përfshirjes së autorëve serbë në listën e librave të përkthyer nga Fondi i Përkthimit Letrar. Në 2017 ministritë përkatëse nënshkruan Memorandumin për Bashkëpunim Kulturor me qëllim forcimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë, shkëmbimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, në përputhje me standardet europiane dhe të UNESCO-s. Ndonëse ky lloj bashkëpunimi sigurisht mund të kontribuojë në përhapjen e simboleve ndërlidhëse dhe krijimin e besimit, ende bashkëpunimi mbetet i varur nga vullneti politik dhe mundësitë financiare të ofruara nga qeveritë. Për momentin, nuk ka një strategji të qartë apo kalendar të aktiviteteve të përbashkëta nga të dy palët se si të vazhdohet me materializimin e deklaratave politike dhe instrumenteve ligjore në fuqi.

## **Konkluzione dhe rekomandime**

Ka disa fusha ku janë shënuar hapa pozitivë gjatë viteve të kaluara. Procesi i anëtarësimit në BE përbën gjitësin për nxitjen e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Serbisë dhe

---

<sup>65</sup> Ibid.

<sup>66</sup> "Serbs increasingly marry Albanians! There is no divorce", *Espresso*, [www.espresso.rs/vesti/drustvo/171717/srbi-sve-vise-zene-albanke-sve-ih-je-vise-razvoda-nema-a-ovako-su-im-ugovoreni-brakovi-video](http://www.espresso.rs/vesti/drustvo/171717/srbi-sve-vise-zene-albanke-sve-ih-je-vise-razvoda-nema-a-ovako-su-im-ugovoreni-brakovi-video), [31 Tetor 2019].

<sup>67</sup> Alpekin H. B., "The issue of 'otherness' has become a cliché, but the problem still exists", *European Institute for Progressive Cultural Policies*, [www.eipcp.net/policies/2015/alpekin/en/print.html](http://www.eipcp.net/policies/2015/alpekin/en/print.html), [31 Tetor 2019].

ekzistojnë mundësi të mira për të kapitalizuar, aktualisht në sektorin ekonomik dhe të politikave të buta. Armiqësitë dhe paragjykimet historike, çështja e pazgjidhur e Kosovës, mungesa e njohurive dhe komunikimit, përkatësia e ndryshme në rrafshin ndërkombëtar dhe graviteti gjeopolitik tradicional (Mesdheu kundrejt Europës Qendrore) ende paraqesin pengesa, të cilat duhen adresuar. Ndërsa disa prej tyre mund të tejkalohen në të ardhmen e afërt, kurse të tjerat jo, ndaj ato ofrojnë një potencial pozitiv drejt normalizimit dhe partneritetit afatgjatë.

Shqipëria dhe Serbia, dy vende të vogla, megjithëse përfaqësojnë dy grupet më të mëdha etnike në rajon, janë boshti kryesor i strukturës komplekse rajonale të organizatave, rrjeteve, nismave të ndryshme që mbulojnë të gjitha çështjet përkatëse, në nivele të ndryshme. Çdo krizë në marrëdhëniet serbo-shqiptare është e dëmshme për të gjithë të tjerët në këtë mjedis dhe për BE-në, si mentori dhe arkitekti kryesor i "qasjes rajonale". Në një të ardhme të afërt, nuk mund të pritët një përmirësim spektakolar i marrëdhënieve dypalëshe. Por përmirësime të vogla mbi baza ditore po ndodhin pavarësisht uljeve dhe ngritjeve të nxitura në sferën politike. Vullneti politik është një gur themelor për përparimin e mëtejshëm, megjithëse stimujt dhe sukseset në fusha të tjera ushtrojnë presion për të ndryshuar qëndrimet politike.

Disa hapa që duhet të merren parasysh nga shtetet janë si vijon:

- Korniza ligjore për marrëdhëniet dypalëshe po përmirësohet me ngadalë, por zhvillimi i saj duhet të inkurajohet më tej;
- Përmirësimi i mëtejshëm i statusit dhe i të drejtave të pakicave duhet të jetë një nga prioritetet;
- Tregtia gjithnjë po e ndjek udhën e saj të ligjshme apo të paligjshme, duke qenë një nga indikatorët më të mirë të zhvillimeve pozitive në marrëdhëniet dypalëshe. Kështu që, çdo pengesë për tregtinë dhe investimet duhet të eliminohet veçanërisht në turizëm dhe në shërbimet e tjera, ku shkëmbimi po bëhet më i balancuar;
- Ndërtimi dhe lidhja e infrastrukturës do t'i afrojnë më afër qytetarët dhe bizneset dhe do të përmirësojë pozicionin e dy vendeve në rrethinat europiane;
- Mobiliteti i qytetarëve dhe profesionistëve është thelbësor për përmirësimin e njohurive dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë;
- Shoqëria civile duhet të inkurajohet për të rritur kontributin e saj në çeljen e rrugëve të reja për partneritet dhe bashkëpunim;
- Rinia është aktori kritik i normalizimit dhe ai më i ndjeshmi, pasi të rinjtë janë ekspozuar më shumë se brezi tjetër ndaj propagandës negative dhe modeleve politike nacionaliste. Kjo është arsyeja pse bashkëpunimi midis universiteteve serbe dhe shqiptare dhe institucioneve të tjera arsimore ose shkencore dhe ekspertëve individualë duhet të inkurajohet dhe mbështetet nga donatorët

kombëtarë, rajonalë dhe europianë, si një levë thelbësore në zhvillimin e modeleve të reja të bashkëpunimit dhe perceptimeve realiste.

- Marrëdhëniet dypalëshe të Shqipërisë dhe Serbisë mund të konsiderohen si një nga rastet më pak të vështira në rajon, pasi nuk ka asnjë barrë të së kaluarës së afërt dhe detyra kryesore është normalizimi dhe jo pajtimi. Të dy vendet mund të kontribuojnë për çlirimin e Kosovës nga kurthi i saj historik dhe hapjen e hapësirës për një aleancë më të gjerë serbo-shqiptare, e cila mund të shndërrojë Ballkanin dhe të kontribuojë në konsolidimin e BE-së.



## Konkluzione: Çfarë mund të mësojë Ballkani Perëndimor nga pajtimi i Vishegradit?

*Jana Juzová*

Në krahasim me zgjerimet e mëparshme, në rastin e procesit të integritimit në BE të Ballkanit Perëndimor, për shkak të konflikteve të fundit të dhunshme, shumë më tepër vëmendje i është kushtuar bashkëpunimit rajonal, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dypalëshe dhe pajtimit në rajon. Kjo është reflektuar kryesisht në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit rajonal dhe të fqinjësisë së mirë, si një nga kushtet e anëtarësimit të kandidatëve për në BE, por tema e pajtimit është një çështje thelbësore edhe në Procesin e Berlinit dhe theksohet vazhdimisht në dokumentet strategjike të BE-së (Strategjia e Komisionit European për Ballkani Perëndimor<sup>68</sup>) dhe takimet politike të nivelit të lartë midis përfaqësuesve të BE-së dhe homologëve të tyre të Ballkanit Perëndimor (siç është Samiti i Sofjes midis liderëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor<sup>69</sup> ose takimet vjetore të përfaqësuesve të lartë politikë nga Vishegradi dhe Ballkani Perëndimor<sup>70</sup>).

Ndërsa BE mbetet një aktor shumë i rëndësishëm në mbështetjen e procesit të pajtimit në Ballkanin Perëndimor, kryesisht për shkak të perspektivës së përbashkët europiane për rajonin, pajtimi nuk mund të shihet vetëm përmes lenteve të integritimit në BE. Është e rëndësishme që liderët politikë në rajon të kuptojnë plotësisht se nuk do të ketë përparim pa pajtim të vërtetë. Për shkak të ndërvarësisë shumë të lartë midis vendeve dhe komuniteteve, është thelbësore që liderët politikë, sikurse dhe njerëzit e zakonshëm të mësojnë jo vetëm të jetojnë në paqe me njëri-tjetrin, por të bashkëpunojnë dhe të komunikojnë në mënyrë pozitive dhe konstruktive. Avancimi i procesit të pajtimit mund të forcojë bashkëpunimin në të gjitha fushat, përfshirë mobilitetin ndërrajonal dhe çështjet ekonomike, duke rritur zhvillimin ekonomik dhe forcimin e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Siç tregojnë shembujt e Vishegradit, ndjekja e përbashkët e qëllimit të integritimit në BE ose angazhimi në formatet e bashkëpunimit rajonal kanë një efekt mbështetës në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe midis vendeve, pasi ato vendosin agjenda të përbashkëta të reja, të ndara nga çështjet dypalëshe, duke u përpjekur për bashkëpunim dhe qasje konstruktive nga të gjitha vendet e përfshira. Sidoqoftë, as platformat e bashkëpunimit rajonal dhe as integritimi në BE nuk zgjidhin në vetvete çështjet dypalëshe dhe është i nevojshëm vullneti politik i shoqëruar nga veprime dhe iniciativa konkrete.

---

<sup>68</sup> European Commission, "A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans", [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf), [3 Nëntor 2019].

<sup>69</sup> European Council, "Sofia declaration of the EU-Western Balkans summit, 17 May 2018", [https://www.consilium.europa.eu/media/34776/sofia-declaration\\_en.pdf](https://www.consilium.europa.eu/media/34776/sofia-declaration_en.pdf), [3 Nëntor 2019].

<sup>70</sup> Visegrad Group, "V4 Statement on the Western Balkans", <http://www.visegradgroup.eu/documents/official-statements/v4-statement-on-the-190912>, [3 Nëntor 2019].

Meqenëse pajtimi është një proces me shumë dimensione dhe aspekte, është e nevojshme përfshirja aktive e të gjithë aktorëve. Përveç elitave politike dhe shoqërisë civile, angazhimi i sferës së biznesit, liderëve fetarë, si dhe aktorëve lokalë (siç janë bashkitë) duhet të inkurajohen për të arritur një pajtim të vërtetë shoqëror.

Një emërues i përbashkët për të gjitha rastet e suksesshme të pajtimit ose normalizimit të marrëdhënieve të paraqitura ishte ndryshimi në ligjërimin politik drejt një qasjeje mirëkuptimi dhe pozitive ndaj palës tjetër. Studimet treguan se elitat politike kanë një ndikim thelbësor mbi narrativat dhe ligjërimet e krijuara tek shoqëritë rreth “tjetrit” dhe kështu mund të mbështesin procesin e pajtimit ose t’a dëmtojnë atë duke ushqyer pakënaqësitë dhe tensionet ekzistuese. Në këtë drejtim, një udhëheqje politike e përgjegjshme është e nevojshme për një proces të suksesshëm të trajtimit të përballjes me të kaluarën dhe vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjellta në frymën e bashkëpunimit, integritimit dhe përparimit drejt një të ardhme të begatë. Ndërsa vullneti politik dhe normalizimi i marrëdhënieve në nivelin më të lartë politik në vetvete nuk është nxitje e mjaftueshme për pajtimin shoqëror, ai është një kusht i domosdoshëm pasi asnjë pajtim mes shoqërive nuk mund të jetë i suksesshëm pa mbështetje politike.

Nevoja për ndryshim të narrativave të promovuara rreth grupeve të tjera etnike dhe fetare, si dhe për kombet e tjera në rajon është e pandashme nga çështja e ndryshimit në sistemin arsimor. Që ky ndryshim të arrihet, është i nevojshëm bashkëpunimi midis historianëve nga vende të ndryshme që përpiqen për krijimin e narrativave të përbashkëta historike të promovuara përmes arsimit formal dhe joformal. Parandalimi i mbizotërimit të narrativave të njëanshme nacionaliste mbi historinë në arsim është me rëndësi thelbësore për të ardhmen e rajonit, pasi rinia është një aktor kryesor në procesin e pajtimit dhe tejkalimit të trashëgimive të së kaluarës, por gjithashtu edhe shumë e ndjeshme dhe që mund të manipulohet lehtësisht. Që të rinjtë të njihen me të gjitha kombet dhe komunitetet, dhe rrjedhimisht të hedhin poshtë narrativat negative dhe paragjykimet ekzistuese dhe në vend të tyre të krijojnë lidhje, ndryshimi në sistemin formal të arsimit duhet të shoqërohet me mbështetje të zgjeruar të programeve të shkëmbimit dhe mobilitetit. Vetëm duke forcuar kontaktet midis qytetarëve në rajon dhe eliminimin e barrierave për lëvizjen rajonale mund të arrihen lidhje reale dhe bashkëpunim i qëndrueshëm.

## **Rekomandime**

### **1. Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi në BE nuk janë zgjidhje për çështjet dypalwshe**

Siç tregojnë rastet e Visegrad, as angazhimi në formate të ndryshme të bashkëpunimit rajonal dhe as përpjekja e përbashkët për integrimin në BE nuk zgjidhin çështjet dhe probleme dypalwshe në marrëdhëniet reciproke. Ndërsa bashkëpunimi rajonal si dhe objektivi i anëtarësimit në BE mund të kenë një efekt lehtësues të caktuar mbi tensionet

dypalëshe, duke vendosur një agjendë të re të bazuar në interesa të përbashkëta, këto çështje duhet të zgjidhen në nivel dypalësh. Integrimi në BE nuk mund të shihet si zgjidhje.

## **2. Është i nevojshëm kuadri ligjor që siguron të drejtat e pakicave dhe mbështet bashkëpunimin**

Rastet e analizuara treguan se një kornizë e përshtatshme ligjore dhe institucione demokratike që sigurojnë përfaqësimin e duhur dhe të barabartë të pakicave kombëtare në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, ndihmojnë në zbutjen e pakënaqësive dhe tensioneve të mundshme ndëretnike. Çdo praktikë diskriminuese përgjatë vijave etnike duhet shmangur. Kërkohej forcim i pronësisë lokale mbi politikën për pakicat për të kapërcyer përçarjen potenciale, dhe në vend të saj të krijohet besim dhe bashkëpunim midis komuniteteve.

## **3. Çdo pengesë për tregtinë dhe mobilitetin përmes rajonit duhet të eliminohet**

Që të ndodhë procesi i pajtimit në të gjithë rajonin, duhet të hiqet çdo pengesë që parandalon tregtinë, turizmin, lëvizjen e të rinjve, bashkëpunimin në sektorin e tretë etj. Përkundrazi, krijimi i infrastrukturës që afron njerëzit dhe bizneset, mbështetja për mobilitetin e qytetarëve dhe profesionistëve, bashkëpunimi në arsim dhe shkencë, si dhe politikën që mbështesin turizmin rajonal janë thelbësore për tejkalimin e ndarjeve ekzistuese. Mundësimi i mobilitetit brenda rajonit është i rëndësishëm veçanërisht për rastin e të rinjve dhe mbështetje e mëtejshme duhet t'i kushtohet këtyre programeve.

## **4. Sistemet arsimore duhet të reformohen dhe të shmangin promovimin e narrativave historike të njëanshme**

Pa një ndryshim thelbësor të sistemeve arsimore në rajon, çdo hap përpara karshi barrës të së kaluarës nuk do të jetë i mundur. Ky ndryshim duhet të kundërshtojë narrativat nacionaliste dhe të njëanshme, të cilat ende mbizotërojnë në edukimin mbi historinë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Që procesi i pajtimit të përparojë, nuk mund të kenë vend në sistemin arsimor narrativat historike të njëanshme, ndezja e paragjytimeve dhe përcarjeve të ndërsjella dhe pengimi i mundshëm i suksesit të nismave të tjera. Për të arritur krijimin e narrativave të përbashkëta historike, të cilat më pas mund të promovohen përmes arsimit, një komision historianësh nga vende të ndryshme të rajonit duhet të themelohet dhe të mbështetet në mënyrën e duhur.

## **5. Të gjithë aktorët duhet të jenë të përfshirë në procesin e pajtimit**

Si një proces shumëdimensional, pajtimi kërkon jo vetëm përfshirjen e udhëheqësve politikë dhe shoqërisë civile, por për shembull edhe të komuniteteve të biznesit dhe

udhëheqësve fetarë duhet të përfshihen në këtë proces. Ndërsa mbështetja politike është thelbësore, procesi i pajtimit kërkon një sinergji midis të dy palëve, një qasje si nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lartë.

## **6. Duhet të mbështeten institucionet që mbështesin aktivitetet e shoqërisë civile që promovojnë pajtimin**

Përpyekjet e shoqërisë civile për përparimin e procesit të pajtimit duhet të mbështeten në mënyrë adekuate në nivel lokal dhe rajonal. Ndërsa kontributet e BE-së dhe donatorëve të tjerë të jashtëm janë të dobishme për të mbështetur aktivitetet në fushën e pajtimit, mungesa e fondeve vendore dhe rajonale çon në pronësi të pamjaftueshme rajonale të procesit. Themelimi i WBF-së është një hap pozitiv në drejtimin e duhur, por krijimi i këshillave dhe fondeve dypalësh, që synojnë të mbështesin nismat e zbatuara nga shoqëria civile dhe aktorët e tjerë vendorë, do të ndihmonte në forcimin e mëtejshëm të procesit.

## **7. Narrativat dhe ligjërimet luajnë një rol vendimtar, retorika e zjarrtë duhet të shmanget**

Narrativat dhe ligjërimi politik rreth palës tjetër kanë një ndikim të rëndësishëm në përparimin ose pengimin e proceseve të pajtimit. Është thelbësore që elitat politike të shmangin abuzimin me tensionet ekzistuese, ankesat dhe pakënaqësitë për përfitimet e tyre politike afatshkurtra, dhe përkundrazi të përqëndrohen në zgjidhje dhe proceset e qëndrueshme afatgjata që çojnë drejt një të ardhmeje më të mirë për rajonin. Praktika e të bërit thirrje të tensioneve historike në lidhje me “palën tjetër”, si një argument për përplasjet e brendshme politike, duhet të përfundojë dhe është e nevojshme që liderët politikë të marrin përsipër përgjegjësinë e rolit që ata luajnë për pajtimin e të gjithë rajonit.

## **8. Njohja e krimeve të së kaluarës dhe gjestet simbolike luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit**

Njohja e krimeve të së kaluarë të kryera nga kombi përkatës është pjesë integrale e procesit të shërimit të të gjitha komuniteteve të prekura. Shembujt tregojnë se një kërkesa për falje publike për krimet e kaluara dhe njohja e viktimave të palës tjetër i hapin rrugën arritjes së një narrative të përbashkët historike, normalizimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të mëtejshëm dhe kanë një rezonancë shumë të mirë tek shoqëritë, duke mbështetur kështu pajtimin në nivel shoqëror. Idealisht, kjo njohje duhet të vijë nga liderët politikë. Megjithatë, edhe gjestet simbolike që vijnë nga aktorë të tjerë (p.sh. bashkësia fetare) kanë një efekt pozitiv të pamohueshëm për procesin e pajtimit.



